



Datë ____/____/2025

KËRKESË

KËRKUES: **Z. Ilir METAJ**, i biri Rexhepit dhe Fiqiretes, dtl 24 mars 1969, lindur në Çepan, Skrapar, me adresë banimi Tiranë, Rr. "Vaso Pasha" Nd. 1817. H.O, Ap.005 ose pranë Partisë Lirisë, Sheshi Ujllson. Përfaqësuar me Akt-Përfaqësimi, të lëshuar më datë 22.05.2025 nga **Studio Ligjore CAKRANI** me NUIS M03525401G av.Kujtim Cakrani me Nr. license 8315 regjistruar pranë Dhomës Avokatisë Fier. Email: Studicakrani01@gmail.com nr.0699413001.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit Nr.57, datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës Lartë, vendimin Nr. 59 (97-2024-333) datë 19.11.2024, të Gjykatës Posaçme Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit Organizuar, vendimin Nr.125, datë 20.10.2024 dhe 130, datë 23.10.2024 të Gjykatës së Shkallës të Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

BAZA LIGJORE: Neni 42/1-131/f dhe 134, paragrafi 1, gërma "g", dhe paragrafi 2 i Kushtetutës së Shqipërisë. Ligji Nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin Nr. 99/2016) "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"

DREJTUAR: GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Të nderuar zotërinj Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Kërkuesi Z. Ilir Metaj, me gjeneralitetet dhe adresën e mësipërme, me anë të kësaj kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ka si shkak veprimet antikushtetuese të tre gjykatave, respektivisht: Vendimin Nr.57 datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës Lartë, që në Dhomë Këshillimi është vendosur: Lënia në fuqi e vendimit Nr. 59 (87-2024-333), datë 19.11.2024 të Gjykatës

së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vendimin Nr.125, datë 20.10.2024 dhe Nr.130 datë 23.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, dhe shfuqizimin e tyre si vendime antikushtetuese.

Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese plotëson përcaktimet ligjore, kërkesi legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës dhe kërkesa është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në ligj, pasi me vendimin e arsyetuar është njohur në datën 16 prill 2025, dhe në kuptim të ligjit është depozituar në sekretarinë e kësaj Gjykate brenda afatit 4-mujor.

Rrethanat e çështjes:

Kërkuesi Z. Ilir Metaj, nga data 24 korrik 2017 dhe deri në datën 24 korrik 2022 ka ushtruar funksionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa më parë ka ushtruar një sërë funksionesh të tjera të rëndësishme si i zgjedhur pa ndërprerje deputet në të gjitha legjislaturat e Kuvendit të Shqipërisë, nga viti 1992-2017, ish-Kryeministër gjatë periudhës nëntor 1999 - shkurt 2002, ministër në disa ministri, dhe prej vitit 2013-2017 ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Pas përfundimit të mandatit të Presidentit të Republikës, më 25 korrik 2022, kërkesi Z. Ilir Metaj mori drejtimin e Partisë Lirisë duke u zgjedhur Kryetar i kësaj force politike dhe më 27 prill 2024 President i saj.

Në të gjithë këtë rrugëtim politik padyshim që kërkesi ka patur edhe përplasje të forta politike, akuza politike nga kundërshtarët politikë, si edhe ngjarje të sajura dhe më pas të kthyer në akuza politike për të dëmtuar imazhin, integritetin dhe moralin e tij, por edhe forcën politike që ai drejton, ish-Lëvizjen Socialiste për Integritet dhe më pas Partinë e Lirisë.

Gjatë ushtrimit të funksionit të Presidentit Republikës, kërkesi Z. Ilir Metaj pati disa herë përplasje apo konflikte me maxhorancën qeverisëse që drejtohej nga Partia Socialiste, për shkak se ai gjithmonë ka mbrojtur vetëm parimet bazë të Kushtetutës dhe shtetit të së drejtës, interesin dhe çështjen kombëtare.

Në veçanti Z. Metaj ka mbrojtur pavarësinë dhe integritetin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nga një nisëm antikushtetuese e Kryeministrit Rama dhe mazhorancës socialiste, e cila në shenjë hakmarrje politike ngriti një komision parlamentar për shkarkimin e tij nga funksioni i Presidentit të Republikës.

Ky komision parlamentar i propozoi Kuvendit të Shqipërisë shkarkimin e tij, por Gjykata Kushtetuese, vendosi se Kuvendi i Shqipërisë nuk kishte të drejtë, duke i gjetur të pabazuara në Kushtetutë motivet për shkarkim të tij.

Gjithashtu, vlen të theksohet se në të gjitha rastet e shqyrtimit të çështjeve, Komisioni i Venecias i dha gjithmonë të drejtë Presidentit Meta.

Në prag të përfundimit të mandatit të tij si President i Republikës, Z. Metaj u atakua mjaft ashpër nga Kryeministri, Edi Rama, i cili më 7 maj 2022, nga tribuna e Asamblesë së Partisë Socialiste, deklaroi publikisht se “e gjithë Shqipëria mezi pret ta shohë përpara SPAK-ut Ilir Metën”. (Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=q-xv6sZS4s4>)

Lufta politike ndaj tij prej maxhorancës qeverisëse, Partisë Socialiste, vazhdoi edhe në përfundim të mandatit si President i Republikës, kur përsëri maxhoranca socialiste nisi një tjetër sulm për denigrimin e figurës së tij duke inskenuar një gjoja e-mail që i kishte mbërritur Kryetares së Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla ku pretendohet se shtetasi Z. Ilir Metaj “kishte qënë spiun i ish-Sigurimit të Shtetit dhe se ky fakt ishte fshehur”, sipas pretendimit.

E gjithë kjo sajese për motive të luftës politike të kundërshtarit përfundoi pa asnjë shpjegim nga ana e atyre që e sajuan (Kuvendi i Shqipërisë) (Autoriteti i Dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit), por padyshim me një kallëzim penal nga ana e ish-Presidentit Z. Ilir Metaj kundër Autoritetit të Dosjeve.

Duke qënë se, asgjë nuk po funksiononte me metodat e shpifjes dhe denigrimit publik, prej maxhorancës socialiste, atëherë futet në lojë “drejtësia”, si një mënyrë tjetër jo vetëm për ta baltosur figurën e tij si të korrupsuar por, edhe për ta izoluar atë politikisht dhe fizikisht, duke i hequr lirinë.

Në kuadër të fushatës linçuese kundër Z. Ilir Metaj, figura që i shërbejnë maxhorancës socialiste, ish-deputetë por edhe individë me probleme me drejtësinë, si të dënuar për dhunë në familje, falsifikime apo për shpifje, u aktivizuan duke bërë jo vetëm akuza politike për korrupsion kundër ish-Presidentit të Republikës, por edhe veprime konkrete si kallëzime penale në prokurorinë e posaçme SPAK.

Në 17 nëntor 2022, Halit Valteri, ish-deputet, dy herë kandidat për deputet i PS dhe anëtar i PS në Këshillin Bashkiak të Tiranës, deklaronte publikisht se “i pari që duhet të arrestohet është Ilir Metaj”.

Gjithashtu, në datën 24 prill 2024, ai deklaronte se “Ilir Metaj do arrestohet dhe nuk i kap zgjedhjet e vitit 2025”.

(Shih: https://www.youtube.com/watch?v=vnW351Z3h_M)

(Shih: <https://www.youtube.com/shorts/CnfAOvhGt0s>)

Në 9 korrik 2024, kallëzuesi Romeo Kara deklaronte se “Metaj do arrestohet shumë shpejt”. (Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=yUI1KxqyFx8>)

Ndërkohë, prej tetorit të vitit 2023, gazetarë të ndryshëm referuar burimeve sipas tyre zyrtare të SPAK paralajmëronin në media arrestimin e Z. Metaj.

(Lexo:

16 shtator 2023/ Nga Meta, te Shkëlzeni, Klodiana Lala tregon goditjet që priten nga SPAK <https://pamfleti.net/aktualitet/nga-meta-te-shkelzeni-klodiana-lala-tregon-goditjet-qe-priten-nga-spa-i188561>

26 tetor 2023/ Gazetari Adriatik Doçi: Ilir Meta do të arrestohet, prandaj është arratisur jashtë Shqipërisë! <https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/gazetari-adriatik-doci-ilir-meta-do-te-arrestohet-prandaj-eshte->

27 tetor 2023/ Artan Hoxha flet për aludimet për arrestimin e Ilir Metës: Ka ikur në Gjermani, por... <https://www.gazetatema.net/politika/artan-hoxha-flet-per-aludimet-per-arrestimin-e-ilir-metes-ka-ikur-ne-gj-i412480>

26 prill 2024/ Deklarata e fortë e gazetares Anduena Llabani: Meta pagoi prokurorin që t'i shtynte arrestimin! <https://javanews.al/deklarata-e-forte-e-gazetares-meta-pagoi-prokurorin-qe-ti-shtynte-arrestimin/>

26 prill 2024/ Nga Ardit Rada: Ilir Meta arrestohet në fundjavë

<https://www.gazetatema.net/blogu-tema/ilir-meta-arrestohet-ne-fundjave-i437371>

26 prill 2024/ “Meta dhe Kryemadhi mund të arrestohen në çdo çast”, Artan Hoxha: SPAK ka tentuar disa herë për ta bërë bashkëpunëtor...

<https://www.botasot.info/shqiperia/2162180/meta-dhe-kryemadhi-mund-te-arrestohen-ne-cdo-cast-artan-hoxha-spak-ka-tentuar-disa-here-per-ta-bere-bashkepunetor->

27 prill 2024/ Plasin skenarët: Arrestimi i Ilir Metës mund të ndodhë në fundjavë, ish-presidenti ka paguar një prokuror për të shtyrë fletë-arrestin, italianët kanë vënë përgjues në Lalëz ku kanë dalë politikanë dhe trafikantë në një tavolinë, priten të tjera goditje “VIP” nga SPAK, ja zyrtarët e rrezikuar <https://sot.com.al/politike/plasin-skenaret-arrestimi-i-ilir-metes-mund-te-ndodhe-ne-fundjave-ish-p-i660429/>

27 prill 2024/ “Thelbi i hetimit ndaj Metës është pasuria”, Klodiana Lala zbulon përplasjet brenda SPAK për arrestimin e Monikës dhe Ilirit

<https://pamfleti.net/politike/thelbi-i-hetimit-ndaj-metes-eshte-pasuria-klodiana-lala-zbulon-perplasj-i224611>

30 prill 2024/ Kush është politikani që do të arrestohet këtë javë? Anila Hoxha: Përfliten Ilir Meta e Monika Kryemadhi, por...

<https://www.gazetatema.net/politika/kush-eshte-politikani-qe-do-te-arrestohet-kete-jave-anila-hoxha-perflit-i437913>

3 maj 2024/ "Ja kur do të ARRESTOHET Ilir Meta"/ Analisti: Ai ia kalon Berishës për... <https://gazeta-shqip.com/aktualiteti/ja-kur-do-te-arrestohet-ilir-meta-analisti-ai-ia-kalon-berishes-per/>

Ndërkohë, më 9 prill 2025, Prokurori i SPAK, Z. Bledar Maksuti pohoi para trupës së Gjykatës Kushtetuese, se “gazetarëve u japim ne leje kur botojnë materiale sekrete”.

(Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=PJLA24rHRU&t=36s>)

Nisja e hetimeve mbi bazën e kallëzimeve të bëra nga eksponentë politikë

Kur nisën kallëzimet penale nga ana e shtetasve:

1. Rezulton se: Në bazë të kallëzimit penal të vitit 2018 të shtetasit Romeo Kara, të depozituar në ish-Prokurorinë e Krimeve të Rënda, shtetasit: **Ilir Metaj, Sali Berisha, Kastriot Ismailaj, Tomas Pleskash dhe Bujar Nepravishta**, për akte korruptive në lidhje me çështjen **DIA-“CEZ Shpërndarje.sh.a”**, duke filluar nga lidhja e kontratës së parë më 1 shtator 2010 dhe në vijim.

Në kallëzimin e tij, shtetasi Romeo Kara ka pretenduar se, gjatë angazhimit të tij si përfaqësues ligjor i OSHE në procedurën e Arbitrazhit në Vjenë, është vënë në dijeni të informacioneve dhe procedurave, nga të cilat ka lindur dyshimi se marrëdhënia kontraktuale/tregtare midis kompanisë “CEZ Shpërndarje.sha” dhe kompanisë DIA, që në fillimet e saj është bazuar në afera korruptive.

Pas ndryshimeve me shkrirjen e Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe krijimin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar (SPAK), në muajin dhjetor të vitit 2019 kjo strukturë nisi veprimet hetimore.

Në kuadër të procedimit penal Nr. 55 të vitit 2019, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka urdhëruar në datën 10.06.2024 regjistrimin e njoftimit të veprave penale, përbri procedimit penal Nr. 55, të vitit 2019 të emrit të shtetasit, Z. Ilir Metaj, i dyshuar për veprën penale **“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”**, e parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Më tej, në datën 10.06.2022, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka bërë regjistrimin e procedimit penal Nr. 122, për veprat penale **“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”** e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, dhe **“Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”**, parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal.

2. Po ashtu, në datën 10.06.2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bërë edhe një regjistrim tjetër, regjistrimin e procedimit penal Nr. 122, për veprat penale **“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”**, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe **“Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”**, e parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimeve të shtetasve Halit Valteri, ish-deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe shtetasit Idajet Beqiri, me profesion avokat, ndaj:

Z. Ilir Metaj, ish-President i Republikës së Shqipërisë, ish-Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, ish-Kryeministër dhe ish-deputet në Kuvendin e Shqipërisë;

Monika Kryemadhi, deputete e Kuvendit të Shqipërisë;

Vangjel Tavo, ish-deputet në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe ndaj:

Iraklis T. Fidetzis, administrator i kompanisë “Dorelita Limited”.

3. Në datën 07.10.2024 është bërë bashkimi i procedimeve Nr. 122/2022 dhe Nr. 125/2022 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në një procedim të vetëm me Nr. 122, të vitit 2022.

Në kallëzimin e tij, kallëzuesi Halit Valteri, pretendon se, nëpërmjet informacioneve të marra nga burime të hapura, sikurse është faqja zyrtare e internetit e FARA, një organizëm në varësi të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, midis **“McKEON GROUP”**, një kompani që ushtron veprimtarinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe kryetarit të saj Z. Ilir Metaj, është lidhur një kontratë lobimi, që financohet nga Lëvizja Socialiste për Integrim, në shuma të konsiderueshme parash, të cilat jo vetëm janë fshehur pasi nuk janë deklaruar në organet kompetente sipas ligjit sikurse është dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

por origjina e tyre është produkt i veprës penale, korrupsioni. Ndërkohë, vetë transferimi i fondeve në mënyrë të fshehtë dhe duke përdorur ndërmjetësimin e kompanisë “Dorelita Limited”, që në fazën e negocimit të marrëveshjes së nënshkruar, mund të bëjë që të jenë konsumuar elementet e figurës së veprës penale, **“Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”**, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

4. Në datën 23.06.2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bërë regjistrimin e procedimit penal Nr. 125, për veprat penale, **“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”**, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal; **“Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”**, e parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal.

Procedimi penal Nr. 125 është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të datës 23.06.2022, i bërë nga shtetasi Halit Valteri i cili ka kallëzuar shtetasit **Ilir Metaj, Monika Kryemadhi, Petrit Vasili, Edmond Panariti, Elona Guri, Muharrem Berisha, Iris Zajmi, Elena Gaçe, Jori Prifti dhe Agron Xhafa**, se kanë konsumuar elemente të veprës penale. **“Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”**, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal, **“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”**, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal; **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, kryer në bashkëpunim”**, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në kallëzimin në fjalë, kallëzuesi Halit Valteri pretendon se nëpërmjet informacioneve të marra nga burime të hapura, sikurse është faqja zyrtare e internetit e **FARA**, një organizëm në varësi të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, midis **“Global Security and Innovative Strategies”** në vijim **G.S.I.S**, një kompani që ushtron veprimtarinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe kryetarit të saj Ilir Metaj, është lidhur një kontratë lobimi e datës 03 Shkurt 2016, që financohet nga Lëvizja Socialiste për Integrim, në shuma të konsiderueshme parash të cilat jo vetëm janë fshehur pasi nuk janë deklaruar në organet kompetente sipas ligjit sikurse është dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por origjina e tyre është produkt i veprës penale, korrupsioni. Ndërkohë vetë transferimi i fondeve në mënyrë të fshehtë mund të bëjë që të jenë konsumuar elementët e figurës së veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”**, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

5. Në datën 07.10.2024 është bërë bashkimi i procedimeve Nr. 122/2022 dhe Nr. 125/2022 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në një procedim të vetëm me Nr. 122, të vitit 2022.

6. Në datën 15.09.2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar procedimin penal Nr. 165, të vitit 2022. Ky procedim është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Idajet Beqiri, i cili kallëzon shtetasit Z. Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi se kanë kryer veprat penale, **“Fshehja e të ardhurave”**, e parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, **“Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë ose të zgjedhurve vendor”**, e parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, **“Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja dhe deklarimi i rrëmë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”**, e parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal, **“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”** e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”**, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në kallëzimin e tij, kallëzuesi pretendon se në vitet 2014 - 2022, çifti Metaj-Kryemadhi, kanë marrë shërbime mjekësore dhe shërbime të kirurgjisë estetike, me qëllim humbjen në peshë dhe ndryshimin e pamjes së tyre. Shërbime të tilla, sipas kallëzuesit, ndër të tjera, janë marrë në klinikën private, **Goldenes Kreuz Vienë, nga mjeku Gerhard Prager**, në klinikën **Casa di Cura Privata Domus Medica, në San Marino**. Sipas kallëzuesit, jo vetëm që kostoja e këtyre shërbimeve mjekësore është e lartë, çka nuk justifikohet me të ardhurat e çiftit **Metaj-Kryemadhi** dhe, si rrjedhojë, nuk janë bërë të ditura në deklaratat vjetore të pasurisë të dorëzuara në Inspektoriatin e Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, por dhe burimet e financimit të tyre janë me shuma parash me origjinë korruptive. Veç kësaj, sipas kallëzuesit, këto lloj trajtimesh mjekësore, kërkojnë shpenzime të vazhdueshme, të cilat nuk mund të justifikohen me të ardhurat e çiftit.

7. Në vijim, nga ana e organit të akuzës është vendosur bashkimi i procedimit Nr. 165, datë 15.09.2022 me procedimin penal Nr. 122, datë 10.06.2022. Në datën 07.10.2024, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është urdhëruar regjistrimi në regjistrin e procedimeve penale të emrit të shtetasve:

Z. Ilir Metaj, i dyshuar për kryerjen e veprave penale, **“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”**, në 3 (tre) raste nga të cilat 2 (dy) raste është kryer në bashkëpunim; **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë”** dhe **“Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rrëmë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”**, të parashikuara nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.

Znj. Monika Kryemadhi, e dyshuar për kryerjen e veprave penale **“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”**, në 2 (dy) raste

dhe në bashkëpunim; **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”**, e kryer në bashkëpunim, si dhe **“Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarami i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”**, parashikuar nga nenet 260 dhe 25, 287/a/2 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.

Z. Piro Xhixho, i dyshuar për kryerjen e veprës penale **“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, e kryer në bashkëpunim”**, e parashikuar nga nenet 260 e 25 të Kodit Penal.

Znj. Ema Çoku, e dyshuar për kryerjen e veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, e kryer në bashkëpunim”**, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

Znj. Fatime Kryemadhi, e dyshuar për kryerjen e veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, e kryer në bashkëpunim”**, e parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

8. Në datën 07.10.2024, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur bashkimin e procedimeve penale Nr. 55/2019 dhe Nr. 122/2022 në një procedim të vetëm duke e numëruar atë me Nr.55/2019.

9. Në funksion të hetimit të gjithanshëm dhe objektiv të këtij procedimi penal, nga ana e organit të akuzës veprimet kanë qënë të ngadalta sepse prej vitit 2019 kur është regjistruar procedimi penal, shtetasi Z. Ilir Metaj është pyetur si person që ka dijeni rreth 4 (katër) vite më pas, në vitin 2023, lidhur me rrethanat e pretendimeve të kallëzuesit dhe janë kryer veprimet hetimore përkatëse për secilin nga faktet e pretenduara.

Në analizë të rezultateve të përfutuara nga këto hetime, organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se në hetim janë përfshirë dhe janë pjesëmarrës në kryerjen e një sërë veprash penale, kryesisht në veprat penale si **“Korrupsioni pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve vendorë”**, **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”**, **“Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarami i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”**, të parashikuara nga nenet 260 dhe 26, 287/2 dhe 257/a/2 të Kodit Penal, në disa raste, në periudha të ndryshme kohore, si dhe në bashkëpunim midis tyre, në lidhje me faktet të cilat janë përshkruar gjerësisht në vendimarrjen e gjykatave.

10. Në këto kushte, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin

dhe Krimin e Organizuar, me kërkesën penale me objekt: Caktimin e masës së sigurimit personal (në mungesë pa pjesëmarrjen e personit të hetuar) ndaj personave në hetim: Z. Ilir Metaj, Monika Kryemadhi, Piro Xhixho dhe Ema Çoku, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të pasqyruara në pjesën hyrëse.

11. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin Nr. 125, datë 20.10.2024, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg” e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim Z. Ilir Metaj, i biri i Rexhep dhe i Fiqirete, i ditëlindjes 24.03.1969, lindur në Çepan, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë banimi: Rr. “Vaso Pasho” Nd. 1817, H. 0, Ap. 005 ose pranë Partisë së Lirisë, Sheshi Uillon, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me gjendje gjyqësore i padënuar, i dyshuar për kryerjen e veprave penale: **“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”** në 3 (tre) raste nga të cilat në 2 (dy) raste është kryer në bashkëpunim, **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”** e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe **“Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarami i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”** të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287/2 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.

Gjykata vlerëson se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personi nën hetim Z. Ilir Metaj, në sajë të pozicionit të tij zyrtar si ministër i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Shqipërisë (METE), ministri e cila ushtronte të drejtat dhe administronte aksionet e shtetit shqiptar pranë shoqërisë “CEZ Shpërndarje sh.a”, nëpërmjet influencës së tij, ka arritur të ndërmjetësojë lidhjen e një kontrate midis “CEZ Shpërndarje sh.a” dhe shoqërisë “Debt Internacional Advisory” me administrator në atë kohë shtetasin, Kastriot Ismailaj, me qëllim që kjo e fundit t’i afente shërbime CEZ duke identifikuar debitorët dhe shumat monetare, që ata i detyroheshin kompanisë.

Personi nën hetim, Z. Ilir Metaj, e ka përdorur influencën e tij për të bërë të mundur lidhjen e kontratës me një shoqëri të drejtuar nga Kastriot Ismailaj, pikërisht për shkak të lidhjeve të mëparshme që ai kishte me këtë person dhe me qëllim ndërtimin në të ardhmen të një marrëdhënie korruptive. Nga provat që i janë bashkëlidhur kërkesës dokumentohet se të paktën në një rast ai ka kërkuar dhe ka marrë nga shtetasi Kastriot Ismailaj shuma të konsiderueshme parash, duke krijuar te gjykata bindjen se në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ka konsumuar në këtë

mënyrë elementët e figurës së veprës penale të **“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve vendorë”** e parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Në saj të detyrës që personi nën hetim, Z. Ilir Metaj ka mbajtur, si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, por dhe si Kryetar i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, rezulton se ai ka ushtruar ndikimin e tij tek Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, personi nën hetim Piro Xhixho i zgjedhur nga Kuvendi në kohën e drejtimit nga Z. Ilir Metaj, me propozim të partisë të drejtuar nga Z. Ilir Metaj, si dhe së bashku me bashkëshorten e tij personin tjetër nën hetim Monika Kryemadhi kanë ushtruar ndikim tek Drejtori i kompanisë së telefonisë celulare “Vodafone”, në mënyrë që të lidhej kontrata midis “Vodafone” dhe “Unifi Communication Inc”, administrator i të cilës ka qënë Adrian Shatku, me qëllim tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare/interkonjeksionin.

Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie, personi nën hetim Z. Ilir Metaj në bashkëpunim me personin tjetër nën hetim Monika Kryemadhi, njëkohësisht dhe bashkëshorte e tij, kanë përfituar jo vetëm nga fitimet mujore të kompanisë, kanë përfituar një kartë krediti, një pjesë të pagesave për shkollimin e fëmijëve, si dhe një pjesë të pagesave të tjera të familjes.

Në këto kushte, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Ilir Metaj ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve vendorë”**, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

Personi nën hetim Z. Ilir Metaj, në kohën që ka qënë Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personin nën hetim Monika Kryemadhi, kanë marrë përsipër të miratojnë/ndryshojnë një ligj në fushën e minierave, që zgjidhte një shqetësim të disa investitorëve në këtë drejtim. Si rezultat i marrëdhënies së krijuar, Z. Ilir Metaj dhe bashkëshortja e tij Monika Kryemadhi kanë pranuar propozimin e biznesmenit Samir Mane për të përfituar një vilë të ndërtuar në kompleksin rezidencial “Rolling Hills”. Pasi ky fakt është marrë vesh dhe nga persona të tjerë duke përfshirë dhe Ambasadorin e Greqisë në Tiranë, ata kanë hequr dorë nga përfitimi duke mos e finalizuar marrëdhënien. Pavarësisht kësaj, ata e kanë pranuar premtimin. Si rrjedhojë, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve vendor”**, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

10.1 Nëpërmjet blerjes së banesës së tij në vitin 2009 në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personin nën hetim Monika Kryemadhi, Z. Ilir Metaj ka përdorur

si truk marrjen e kredive bankare, më pas shlyerja e kredive është bërë nga vjehrra e tij me shuma të konsiderueshme parash, të cilat as i ka patur dhe as ka patur mundësi t'i siguronte. Në këtë mënyrë, është bërë futja në sistemin bankar dhe investimi në pasuri të paluajtshme e shumave të konsiderueshme monetare, pa burim të ligjshëm, të dyshuara si të prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit. Në këtë mënyrë krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Z. Ilir Metaj në bashkëpunim me personat e tjerë në hetim, bashkëshorten Monika Kryemadhi dhe vjehrrën e tij Fatime Kryemadhi, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim”**, e parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

10.2 Nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të lobimit, marrjes së shërbimeve nga këto kontrata, dhe financimit me shuma të konsiderueshme parash nga burime të pajustificuara të transferuara në bankat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga llogari të padeklaruara prej tij, si dhe mosdeklarimi i shpenzimeve sipas ligjit në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Z. Ilir Metaj ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në këtë mënyrë më shumë se një herë”**, e parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, në dy rrethana cilësuese të kryerjes së saj në bashkëpunim dhe më shumë se një herë. Nëpërmjet mosdeklarimit të shumave të konsiderueshme monetare të përdorura për shpenzime luksi dhe jetese në deklaratat vjetore të pasurisë, veçanërisht deklaratën e pasurisë të vitit 2019 të depozituar në I.L.D.K.P.K.I në vitin 2020, sipas ligjit Nr. 9049 datë 10 Prill 2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve” i ndryshuar, ndërkohë që dyshohet se ka qënë në pamundësi për t'i siguruar këto shuma parash nëpërmjet burimeve të ligjshme, por dhe dyshimi për përfshirje në veprimtari kriminale të korrupsionit, pra paligjshmëria e burimeve, personi nën hetim Z. Ilir Metaj dyshohet se gjatë plotësimit të deklaratave vjetore të pasurisë dhe më konkretisht periodikun e vitit 2019 dhe dorëzimin e saj në I.L.D.K.P.K.I në vitin 2020, ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Refuzimi për deklarim, mosdeklarimit, deklarimit të rremë të pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike, ose i çdo personi që ka detyrimin për deklarim”** e kryer kjo kryesisht në formën e deklarimit të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Po kështu, mbi të dhënat dhe deklaratimet e sipërcituara që i janë bashkëngjitur kësaj kërkesë, mbështetet edhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se personi nën hetim Monika Kryemadhi, ka konsumuar elementët e figurave të veprave të **“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve”** e kryer në bashkëpunim dhe 2 (dy) herë, parashikuar nga neni 260 e 25 të Kodit Penal, **“Pastrimit**

të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklaram, deklarimit të rremë të pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike, ose i çdo personi që ka detyrimin për deklaram e kryer në formën e deklarimit të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme “parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Në sajë të detyrës që personi nën hetim Monika Kryemadhi ka mbajtur, si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, por dhe bashkëshortja e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, dhe ka ushtruar ndikimin e saj tek Kryetari i **Autoritetit të Komunikimeve Elektronike** dhe Postare, personi nën hetim **Piro Xhixho** i zgjedhur nga Kuvendi me propozim të partisë ku ajo aderon dhe ku ka qënë kryetare, si dhe së bashku me bashkëshortin e saj personin tjetër nën hetim **Z. Ilir Metaj** kanë ushtruar ndikim tek Drejtori i kompanisë së telefonisë celulare “Vodafone”, në mënyrë që të lidhej kontrata midis “**Vodafone**” dhe “**Unifi Communication Inc.**”, administrator i të cilës ka qënë Adrian Shatku me qëllim tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare/ interkonjeksionin.

Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie, personi nën hetim Monika Kryemadhi në bashkëpunim me personin tjetër nën hetim Z. Ilir Metaj, njëkohësisht dhe bashkëshort i saj, kanë përfituar jo vetëm nga fitimet mujore të kompanisë, kanë përfituar një kartë krediti, një pjesë të pagesave për shkollimin e fëmijëve, si dhe një pjesë të pagesave të tjera të familjes, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se në këtë mënyrë kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “**Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve vendorë**”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

10.3 Personi nën hetim Monika Kryemadhi, në kohën që ka qënë deputete e Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me bashkëshortin e saj, personin nën hetim **Z. Ilir Metaj**, kanë marrë përsipër të miratojnë/ndryshojnë një ligj në fushën e minierave, që zgjidhte një shqetësim të disa investitorëve në këtë drejtim. Si rezultat i marrëdhënies së krijuar, Monika Kryemadhi dhe bashkëshorti i saj Z. Ilir Metaj, kanë pranuar propozimin e biznesmenit Samir Mane për të përfituar një vilë të ndërtuar në kompleksin rezidencial “**Rolling Hills**”. Pasi ky fakt është marrë vesh dhe nga persona të tjerë duke përfshirë dhe Ambasadorin e Greqisë në Tiranë, ata kanë hequr dorë nga përfitimi duke mos e finalizuar marrëdhënien.

Pavarësisht kësaj, ata kanë pranuar premtimin dhe si rrjedhojë krijohet dyshimi i arsyeshëm se kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “**Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve vendorë**”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

Nëpërmjet blerjes së banesës së saj në vitin 2009 në bashkëpunim me bashkëshortin e saj, personin nën hetim Z. Ilir Metaj, Monika Kryemadhi ka përdorur si truk marrjen e kredive bankare, më pas shlyerja e kredive është bërë nga nëna e saj me shuma të konsiderueshme parash, të cilat rezultojnë se nuk i ka patur dhe as ka patur mundësi që t'i sigurojë. Në këtë mënyrë, është bërë futja në sistemin bankar, dhe investimi në pasuri të paluajtshme e shumave të konsiderueshme monetare, pa burim të ligjshëm, të dyshuara si të prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit. Në këtë mënyrë, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Monika Kryemadhi në bashkëpunim me personat e tjerë në hetim bashkëshortin e saj Z. Ilir Metaj dhe nënën e saj Fatime Kryemadhi, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”** e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

Nëpërmjet mosdeklarimit të shumave të konsiderueshme monetare të përdorura për shpenzime luksi dhe jetese në deklaratat vjetore të pasurisë, veçanërisht deklaratën e pasurisë të vitit 2019 të depozituar në I.L.D.K.P.K.I në vitin 2020, sipas ligjit Nr. 9049 datë 10 Prill 2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve” i ndryshuar, ndërkohë rezultojnë jo vetëm pamundësia për t'i siguruar këto shuma parash nëpërmjet burimeve të ligjshme, por dhe dyshohet përfshirja në veprimtari kriminale të korrupsionit, pra paligjshmëria e burimeve.

Personi nën hetim Monika Kryemadhi gjatë plotësimit të deklaratave vjetore të pasurisë dhe më konkretisht periodikun e vitit 2019 dhe dorëzimin e saj në I.L.D.K.P.K.I në vitin 2020, krijon dyshimin e arsyeshëm se ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Refuzimi për deklarim, mosdeklarimit, deklarimit të rremë të pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike”**, ose i çdo personi që ka detyrimin për deklarim e kryer kjo kryesisht në formën e deklarimit të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Po kështu, mbi të dhënat dhe deklaratimet e sipërcituara, që i janë bashkëngjitur kësaj kërkesë, mbështetet edhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se personi nën hetim Piro Xhixho, jo vetëm që nuk ka ushtruar detyrën e tij për të kontrolluar ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë të Kompanisë UNIFI Holding INC, e cila për një periudhë kohe e ka ushtruar aktivitetin pa u paisur me kod ISPC, por ka ndikuar tek Drejtori Ekzekutiv i kompanisë së telefonisë celulare “Vodafone”, me qëllim që kjo kompani të lidhë kontratën dhe t'i krijojë mundësinë kompanisë “UNIFI Holding INC”, për të ushtruar aktivitetin e interkoneksionit të thirrjeve telefonike ndërkombëtare.

Kjo veprimtari e tij, është bërë duke mos zbatuar detyrën sipas ligjit, duke ju bindur kërkesave të personave nën hetim Monika Kryemadhi dhe Z. Ilir Metaj, të cilët në fakt

kanë patur interesa ekonomike tek kompania në fjalë. Kontrolli në fjalë, u krye vetëm pas largimit të personit nën hetim Piro Xhixho nga detyra dhe që çoi në ndëshkimin administrativ të kësaj kompanie, për shkak të zhdukjes prej saj të paisjes kompjuterike, që ruante treguesit e aktivitetit të interkonjeksionit për periudhën 2014 - 2017. Ky qëndrim në detyrë i personit nën hetim Piro Xhixho, dyshohet se është bërë me qëllim për të siguruar përfitim të parregullt për të tretë dhe konkretisht personat nën hetim Z. Ilir Metaj e Monika Kryemadhi, duke çuar në këtë mënyrë në një lloj kthimi nderi që ata i kishin bërë më parë, duke e caktuar në këtë detyrë.

Nga sa më sipër, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Piro Xhixho ka konsumuar në bashkëpunim me personat e tjerë nën hetim Z. Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi, në rolin e ndihmësit të këtyre të fundit, elementët e figurës së veprës penale të **“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror dhe të zgjedhurve”** parashikuar nga nenet 260 e 25 të Kodit Penal.

10.4 Po kështu, mbi të dhënat dhe deklaratimet e sipërcituara, që i janë bashkëngjitur kësaj kërkesë, mbështetet edhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se personi nën hetim Ema Çoku, ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, e kryer në bashkëpunim”** me Fatime Kryemadhin, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i Kodit Penal, por e kryer sipas pikës të parë të këtij neni, nëpërmjet ndihmës së dhënë për të fshehur ose mbuluar natyrën e vërtetë të produkteve të veprës penale.

Shtetasja Ema Çoku është në lidhje të afërt familjare me shtetasit Z. Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi. Kjo shtetase nëpërmjet punonjëses së saj, Vera Bazi, ka paguar në vitin 2013, për aktivitet argëtues të LRI-së, shumën 4.103.605 lekë, ku ka paguar këtë vit, 2013, me derdhje cash në bankë për llogari të Hotel Rogner, ka bërë donacione në vlerën 7.000 Euro në vitin 2016 për subjektin LSI, ka përpiluar deklaratë noteriale Nr. 630 Rep. Nr. 234 Kol. datë 06 Shkurt 2019, ku ka deklaruar se gjatë viteve 2011-2019 i ka transferuar shtetases Monika Kryemadhi në llogarinë e saj bankare shumën 16.000 Euro dhe 1.500.000 lekë për blerjet që Monika ka bërë me kartë për llogari të Ema Çokut, si dhe ka përpiluar deklaratë noteriale Nr. 1846 Rep, nr. 897 Kol, datë 22 Maj 2024, nëpërmjet të cilës deklaroi se në fillim të vitit 2010 i ka dhënë Fatime Kryemadhit, hua shumën 220.000 Euro. Kompania e saj B.S.K shpk, ka paguar në vitin 2013, shpenzimet e akomodimit në Hotel Rogner për shtatë shtetas të huaj midis të cilëve edhe John Moreira dhe Patrick Faust, shumën 1.142.000 lekë, Vera Bazi, në datën 30 Prill 2013 ka derdhur cash në llogarinë e Hotel Rogner, shumën 10.000 Euro për shërbimin, ushqim dhe pije, banket i LRI-s.

Gjithashtu Vera Bazi në datën 11 Qershor 2014 ka derdhur cash në bankën Intesa Sanpaolo, shumën 300.000 lekë për shërbimin event organizuar në datën 10 Qershor

2013 nga LRI dhe në datën 25 Shtator 2014, ka derdhur cash shumë 363.910 lekë për shërbimin event i organizuar në datën 10 Qershor 2013 nga LRI. Shtetasja Ema Çoku, dhe kompania e saj BSK shpk, kanë qënë vazhdimisht debitorë në bankat e nivelit të dytë për shkak të kredive në vlera të mëdha, si dhe të ardhurat e siguruar nga biznesi bazuar në bilancet e deklaruar në organet tatimore kanë qënë minimale.

Deklarata noteriale Nr. 1846 Rep, Nr. 897 Kol, datë 22 Maj 2024, ku ajo deklaroi se në fillim të vitit 2010 i ka dhënë Fatime Kryemadhi, hua shumë 220.000 Euro, krijon dyshimin e arsyeshëm se është krijuar me qëllimin që të ndihmojë shtetasen Fatime Kryemadhi për të justifikuar shumat e parave të cilat gjithashtu dyshohet se burojnë nga veprimet korruptive të Z. Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi.

Kjo deklaratë rezulton se është nënshkruar pas pyetjes së personave nën hetim Z. Ilir Metaj, Monika Kryemadhi dhe Fatime Kryemadhi, vënies në dijeni të tyre në lidhje me faktet e konstatuara nga organi procedues, duke përfshirë dhe mungesën e të ardhurave të siguruar nga burime të ligjshme, për të përballuar jetesën dhe shpenzimet e luksit. Në këtë mënyrë krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Ema Çoku ka konsumuar veprën penale të **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, i kryer në bashkëpunim”** me shtetasen Fatime Kryemadhi, e parashikuar nga neni 287 paragrafi 2 i Kodit Penal, por të paragrafit të parë të këtij neni, nëpërmjet ndihmës së dhënë për të fshehur ose mbuluar natyrën e vërtetë të produkteve të veprës penale. Fakti penal për të cilin dyshohen personat nën hetim parashikohet nga ligji si vepër penale dhe më konkretisht i korrespondon vepra penale:

“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”, kryer në bashkëpunim;

“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim”;

“Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram” janë të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287/2 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.

Këto vepra penale për të cilat dyshohen personat në hetim nuk rezulton që të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale apo të dënimit, si dhe këto vepra nuk rezulton që të jenë shfuqizuar apo amnistuar. Në këto kushte, rezulton se plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale. Në vështrim të kushtit të tretë, Gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat personat në hetim nuk mund të merren si të pandehur apo që të mund të dënohen pasi ata e kanë mbushur moshën e parashikuar në ligj për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm. Gjykata çmon të

theksojë se në zbatim të parashikimeve ligjore të KPP përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet që të verifikohet nëse ekziston edhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i KPP që realisht janë disa: Ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; Largimi i të pandehurit ose rreziku që ai të largohet; Rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij mund të kryejë krime të rënda ose të të njejtit lloj me atë për të cilin procedohet. Këto kushte të veçanta të cilat duhet të mbajë parasysh gjykata në caktimin e masës së sigurimit personal janë alternative dhe jo kumulative.

Nëse në gjykim vërtetohet vetëm njëri prej tyre, gjykata nuk e ka detyrim të hetojë dhe të vërtetojë ekzistencën apo mosekzistencën e kushteve të tjera që sipas ligjit justifikojnë apo jo caktimin e masës së sigurimit. Gjykata, vlerëson se në rastin konkret, duke analizuar rrethanat e faktit, duke pasur parasysh rrezikshmërinë e veprave penale për kryerjen e së cilave dyshohen personat nën hetim, sanksionet e parashikuara në dispozitat përkatëse si dhe pasojat e ardhura, vlerëson se plotësohet kushti i parashikuar në shkronjën a të pikës 3 të nenit 228 të KPP (ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës).

Për personat nën hetim Z. Ilir Metaj, Monika Krymadhi, Piro Xhixho dhe Ema Çoku plotësohet kushti i parë i veçantë, ai i parashikuar në shkronjën a të pikës 3 të nenit 228 të KPP, pasi gjykata vlerëson se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të hetimit të kësaj çështjeje.

Për faktin e ndodhur po zhvillohen hetime në drejtim të sqarimit të plotë të rrethanave të faktit dhe duke marrë në konsideratë jo vetëm pozicionin zyrtar që personat nën hetim kanë pasur apo kanë: Z. Ilir Metaj ka qenë deputet, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, disa herë Ministër, Kryeministër dhe së fundmi President i Republikës; Monika Kryemadhi aktualisht gëzon statusin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë; Piro Xhixho ka qenë ish-kryetar i AKEP dhe Ema Çoku (lidhje e afërt e personave nën hetim Z. Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi) për shkak të marrëdhënieve të krijuara si rezultat i ushtrimit të funksioneve të mësipërme dhe influencave që mund të ketë tek persona të tjerë, ekziston mundësia që të ndërhyjnë dhe të ndikojnë në prishjen apo asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, që do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal objekt gjykimi. Në këto rrethana, me plotësimin e kushteve dhe kriterëve si mësipër, gjykata vlerëson caktimin e një mase sigurimi personal me karakter shtrëngues ndaj personave nën hetim.

Gjykata për caktimin e masës së sigurimit për secilin prej personave në hetim vlerëson si më poshtë:

10.5 Në lidhje me kërkesën e organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” e parashikuar nga neni 238 i KPP ndaj personit në hetim Z. Ilir Metaj, i dyshuar për kryerjen e veprave penale **“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”** në 3 (tre) raste nga të cilat në 2 (dy) raste është kryer në bashkëpunim; **“Pastrimi produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një here”** dhe **“Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”**, të parashikuara nga nenet 260 e 25, 287/2 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.

Në lidhje me personin nën hetim Z. Ilir Metaj, gjykata vlerëson se në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij duhen mbajtur në konsideratë këto kritere/rrethana: gjendjen ekonomike, shoqërore e familjare e tij, rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale për të cilat dyshohet duke u nisur nga masa e dënimit që parashikon secila prej tyre, mënyrën e kryerjes së secilës prej tyre, rrezikshmërinë shoqërore të autorit, faktin që personi nën hetim po hetohet për pesë vepra penale të ndodhur në kohë të ndryshme, faktin që personi nën hetim dyshohet se është recidivist specifik në veprën penale të korrupsionit, si dhe përbërjen e gjendjes së tij familjare. Gjukata vlerëson se të gjitha këto rrethana, e bëjnë të domosdoshme dhe në përputhje me nevojën e sigurimit, caktimin ndaj personit nën hetim Z. Ilir Metaj të masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, e parashikuar nga neni 238 i KPP.

Në vendimin e gjykatës kjo masë siguri personal është masa më e përshtatshme në raport me rëndësinë e fakteve të kryera nga personi nën hetim Z. Ilir Metaj, si dhe masën e dënimit që parashikohet nga neni 260 i Kodit Penal, (katër deri në dymbëdhjetë vjet burgim), me masën e dënimit të parashikuar nga neni 287 i KP (nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim), me masën e dënimit të parashikuar nga neni 257/a/2 i KP (deri në tre vite burgim në maksimum) si dhe faktin që secili episod konsiderohet si vepër më vete. Masa e sigurimit “Arrest në burg” e parashikuar nga neni 238 i KPP për personin nën hetim Z. Ilir Metaj, është e përshtatshme në raport me rëndësinë e faktit. Gjithashtu, gjykata konstaton se nuk ekziston asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 230/2 i KPP për ndalimin ligjor të vendosjes së një mase të tillë nga gjykata. Për gjithë sa më sipër u analizua, gjykata çmon se duhet të pranohet kërkesa e organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i KPP ndaj personit në hetim Z. Ilir Metaj.

10.6 Konkretisht, në gjendjen që janë aktet në ngarkim të personave në hetim ka rrethana që tregojnë se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personi nën hetim Z. Ilir Metaj, në sajë të pozicionit të tij zyrtar si ministër i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Shqipërisë, (METE), ministri e cila ushtronte të drejtat dhe administronte aksionet e shtetit shqiptar pranë shoqërisë “CEZ Shpërndarje

sh.a”, nëpërmjet influencës së tij, ka arritur të ndërmjetësojë lidhjen e një kontrate midis “CEZ Shpërndarje sh.a” dhe shoqërisë “Debt Internacional Advisory” me administrator në atë kohë shtetasin Kastriot Ismailaj, me qëllim që kjo e fundit t’i afronte shërbime CEZ duke identifikuar debitorët dhe shumat monetare që ata i detyroheshin kompanisë.

Personi nën hetim Z. Ilir Metaj, e ka përdorur influencën e tij për të bërë të mundur lidhjen e kontratës me një shoqëri të drejtuar nga Kastriot Ismailaj pikërisht për shkak të lidhjeve të mëparshme që ai kishte me këtë person, dhe me qëllim ndërtimin në të ardhmen të një marrëdhënie korruptive. Nga provat që i janë bashkëlidhur kërkesës dokumentohet se të paktën në një rast ai ka kërkuar dhe ka marrë nga shtetasi Kastriot Ismailaj shuma të konsiderueshme parash, duke krijuar te gjykata bindjen se në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ka konsumuar në këtë mënyrë elementët e figurës së veprës penale të **“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve vendorë”** e parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. Në sajë të detyrës që personi nën hetim Ilir Metaj ka mbajtur si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, por dhe si Kryetar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, rezulton se ai ka ushtruar ndikimin e tij tek Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, personi nën hetim Piro Xhixho i zgjedhur nga Kuvendi në kohën e drejtimit nga Z. Ilir Metaj, me propozim të partisë të drejtuar nga Ilir Metaj, si dhe së bashku me bashkëshorten e tij personin tjetër nën hetim Monika Kryemadhi kanë ushtruar ndikim tek Drejtori i kompanisë të telefonisë celulare “Vodafone”, në mënyrë që të lidhej kontrata midis “Vodafone” dhe Unifi Communication Inc, administrator i të cilës ka qënë Adrian Shatku me qëllim tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare/ interkonjeksionin.

Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie, personi nën hetim Z. Ilir Metaj në bashkëpunim me personin tjetër nën hetim Monika Kryemadhi njëkohësisht dhe bashkëshorte e tij, kanë përfituar jo vetëm nga fitimet mujore të kompanisë, kanë përfituar një kartë krediti, një pjesë të pagesave për shkollimin e fëmijëve, si dhe një pjesë të pagesave të tjera të familjes. Në këto kushte, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Ilir Metaj ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve”** e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

Personi nën hetim Z. Ilir Metaj, në kohën që ka ushtruar detyrën si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personin nën hetim Monika Kryemadhi, kanë marrë përsipër të miratojnë/ndryshojnë një ligj në fushën e minierave, që zgjidhte një shqetësim të disa investitorëve në këtë drejtim. Si rezultat i marrëdhënies së krijuar, Z. Ilir Metaj dhe bashkëshortja e tij Monika Kryemadhi kanë pranuar propozimin e biznesmenit Samir Mane për të përfituar një vilë të ndërtuar në kompleksin rezidencial “Rolling Hills”. Pasi ky fakt është marrë vesh dhe nga persona

të tjerë duke përfshirë dhe Ambasadorin e Greqisë në Tiranë, ata kanë hequr dorë nga përfitimi duke mos e finalizuar marrëdhënien. Pavarësisht kësaj, ata e kanë pranuar premtimin.

Si rrjedhojë, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve vendor”**, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal. Nëpërmjet blerjes së banesës së tij në vitin 2009 në bashkëpunim me bashkëshorten e tij, personin nën hetim Monika Kryemadhi, Z. Ilir Metaj ka përdorur si truk marrjen e kredive bankare, më pas shlyerja e kredive është bërë nga vjehrra e tij me shuma të konsiderueshme parash, të cilat as i ka patur dhe as ka patur mundësi ti siguronte. Në këtë mënyrë, është bërë futja në sistemin bankar dhe investimi në pasuri të paluajtshme e shumave të konsiderueshme monetare, pa burim të ligjshëm, të dyshuara si të prejardhura nga veprimtaria kriminale e korrupsionit.

Në këtë mënyrë, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Z. Ilir Metaj në bashkëpunim me personat e tjerë në hetim, bashkëshorten Monika Kryemadhi dhe vjehrrën e tij Fatime Kryemadhi, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim”**, e parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

11.1 Nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të lobimit, marrjes së shërbimeve nga këto kontrata, dhe financimit me shuma të konsiderueshme parash nga burime të pajustificuara të transferuara në bankat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga llogari të padeklaruara prej tij, dhe mosdeklarimi i shpenzimeve sipas ligjit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim Ilir Metaj ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në këtë mënyrë më shumë se një herë”**, e parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, në dy rrethana cilësuese të kryerjes së saj, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë.

Nëpërmjet mosdeklarimit të shumave të konsiderueshme monetare të përdorura për shpenzime luksi dhe jetese në deklaratat vjetore të pasurisë, veçanërisht deklaratën e pasurisë të vitit 2019 të depozituar në **I.L.D.K.P.K.I** në vitin 2020, sipas ligjit Nr. 9049 datë 10 Prill 2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrim financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve” i ndryshuar, ndërkohë që dyshohet se ka qënë në pamundësi për t’i siguruar këto shuma parash nëpërmjet burimeve të ligjshme, por dhe dyshimi për përfshirje në veprimtari kriminale të korrupsionit, pra paligjshmëria e burimeve, personi nën hetim Z. Ilir Metaj dyshohet se gjatë plotësimit të deklaratave vjetore të pasurisë dhe më konkretisht periodikun e vitit 2019 dhe dorëzimin e saj në **I.L.D.K.P.K.I** në vitin 2020, ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të **“Refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, deklarimit të rremë të pasurive,**

interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, ose çdo personi që ka detyrimin për deklaram e kryer kjo kryesisht në formën e deklaramit të rremë në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Me vendimin nr. 59 datë 19.11.2024 Gjykata e Posacme Apelit për Korrupsionin dhe krimin Organizuar vendosi, lënien në fuqi të vendimit 125 datë 20.10.2024 dhe vendimin nr 130 datë 23.10.2024 të Gjykatës Posacme Kunder Korrupsionit dhe krimin Organizuar.

11.2 Pas ankimit në Gjykatën e Lartë të vendimeve të të dy gjykatave të shkallës parë dhe Apelit, duke parashtruar asaj arsyet pse vendimet e tyre janë të pabazuara në ligj dhe prova, duke i përmendur edhe arsyet pse masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues nuk është propocionale me rrethanat e paraqitura nga organi akuzës, dhe se nuk jemi përpara parashikimeve të nenit 228/3 229 dhe 17-27-28 Kushtetutës Shqipërisë por edhe nenit 5/3 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, Gjykatën e Lartë duke mos marrë parasysh anjë nga shkeljet e pretenduara nga përfaqësuesit ligjor të ish Presidentit Ilir Metaj, me vendimin nr. 00-2025-364-57 datë 27.02.2025 vendosi: lënien në fuqi të vendimit nr. 59 datë 19.11.2024 të Gjykatës Posacme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

12.1 Në lidhje me personin nën hetim Z. Ilir Metaj, gjykata vlerëson se në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij mbahen në konsideratë këto kritere/rrethana: gjendjen ekonomike, shoqërore e familjare e tij, rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale për të cilat dyshohet duke u nisur nga masa e dënimit që parashikon secila prej tyre, mënyrën e kryerjes së secilës prej tyre, rrezikshmërinë shoqërore të autorit, faktin që personi nën hetim po hetohet për pesë vepra penale të ndodhur në kohë të ndryshme, faktin që personi nën hetim dyshohet se është recidivist specifik në veprën penale të Korrupsionit si dhe përbërjen e gjendjes së tij familjare. Gjykata vlerëson se të gjitha këto rrethana, e bëjnë të domosdoshme dhe në përputhje me nevojën e sigurimit vazhdimin ndaj personit nën hetim Z. Ilir Metaj të masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, e parashikuar nga neni 238 i i Kodit të Procedurës Penale.

Në vlerësimin e gjykatës kjo masë sigurimi personal është masa më e përshtatshme në raport me rëndësinë e fakteve të kryera nga personi nën hetim Ilir Metaj, si dhe masën e dënimit që parashikohet nga neni 260 i Kodit Penal, (katër deri në dymbëdhjetë vjet burgim), me masën e dënimit të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim), me masën e dënimit të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal (deri në tre vite burgim në maksimum) si dhe faktin që secili episod konsiderohet si vepër më vete.

Masa e sigurimit “Arrest në burg” e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për personin nën hetim Z. Ilir Metaj, është e përshtatshme në raport me rëndësinë e faktit. Gjithashtu, gjykata konstaton se nuk ekziston asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 230/2 i Kodit të Procedurës Penale për ndalimin ligjor të vendosjes dhe vazhdimin të një mase të tillë nga gjykata.

Pra siç rezulton, Gjykata e Lartë me vendimin e datës 27.02. 2025 në analizën ligjore vlerëson se, pretendimet e ngritura nga ish Presidenti Ilir Metaj nuk i përmbahet shkaqeve të percaktuara nga neni 432/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke vendosur mospranimin e rekursit. Këtë qëbdrim Gjykata e Lartë e ka shoqëruar edhe me referencë të jurisprudence Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në pikën 22 të vendimit Gjykata e Lartë gjykata ka bërë një pasqyrim të asaj të ka ndodhur në gjykatën e apelit duke përshkruar momentet procedurale atë të arrestimit, marrjes në pyetje të personit nën hetim etj, por pa ju futur arsyetimit përse ish presidenti republikës duhet të qëndroj me masën shtrënguese “arresti me burg”?

Shkalla e parë, në vendimin Nr. 125 të datës 20.10.2024 në dhomë këshillimi ka vendosur caktimin e masës sigurimit personal “arresti me burg” ndaj shtetasit Z. Ilir Metaj duke u bazuar thjesht tek kërkesa e organit të procedurës, ku ajo dyshonte se shtetasi Z. Ilir Metaj ka konsumuar tre vepra penale të cilat janë të rënda në kuptimin e masës së dënimit. Pra me këtë arsyetim Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur ta pranojë kërkesën e organit të akuzës duke nxjerrë edhe urdhër arresti.

Në datën 23.10.2024 pas ekzekutimit të vendimit të gjykatës, shtetasi Z. Ilir Metaj del përpara Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit Organizuar për marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues të caktuar me vendimin Nr. 125 datë, 20.10.2024.

Pas marrjes në pyetje të ish-Presidentit, Z. Ilir Metaj, gjykata me vendimin Nr. 130/2024 vendosi: Vazhdimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg”, parashikuar në nenin 238 i Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se: Veprat penale të dyshuara janë të rënda dhe marzhi i dënimit nëse deklarohet fajtor është i madh. Por pa ju futur fare arsyetimit përse ndaj ish-Presidenti Z. Ilir Metaj, si person nën hetim nuk mund të aplikohet një tjetër masë siguri nga ato që parashikon Kodi i Procedurës Penale?

Nisur nga ky vendim i Gjykatës së Shkallës Parë personi nën hetim Z. Ilir Metaj vendosi ta apelojë vendimin në Gjykatën e Apelit duke arsyetuar se: Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është një vendim i pabazuar në prova dhe fakte pasi organi

i akuzës është akoma në fazën hetimore dhe se nuk ka prova konkrete që të implikojnë atë drejtëpërdrejt në aferat korruptive që mendon apo supozon organi i akuzës.

Në këtë kuptim duke nisur edhe nga rëndësia e personalitetit të tij si ish-President i Republikës apo ish-Kryetar Kuvendi dhe President i Partisë Lirisë, forca e dytë politike opozitare dhe partia e tretë politike në vend, ai kërkoi aplikimin e një mase tjetër nga ato që parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Gjykata e Apelit me vendimin Nr. 59 datë 19.11.2024 vendosi ta lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, që nënkupton masën me karakter shtrëngues të “Arrest në burg”.

Rrethanat e arrestimit të Z. Ilir Metaj

Më 21 tetor 2024, në një kryqëzim të ngarkuar në Tiranë pranë “Casa Italia”, Z. Ilir Metaj u arrestua nga Prokuroria e Posaçme, në mënyrë denigruese, degraduese dhe çnjerëzore nga persona me maska dhe të armatosur rëndë, të veshur me uniforma të zeza pa logo, pa distinktiva apo shenja identifikuese, të cilët rrethuan zonën duke krijuar një atmosferë terrori për qytetarët që ishin të pranishëm, duke e tërhequr zvarrë nga makina që udhëtonte, dhe pa iu komunikuar një vendim gjykatë për arrestin.

Ish-Presidenti i Republikës, Z. Ilir Metaj u nxorr forcërisht nga automjeti me të cilin udhëtonte, u rrëmbye me dhunë, u tërhoq zvarrë mes publikut nga personat me maska, me një trajtim kriminal, denigrues dhe degradues, pa ju lexuar të drejtat, që i takonin, sipas Kushtetutës dhe po në mënyrë të dhunshme u detyrua forcërisht të hipte në një nga automjetet private që i bllokuan rrugën.

(Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=GyRp1yR5LFs>)

Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese!

Në këtë kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kemi si shkak vendimet antikushtetuese të të tre gjykatave; Gjykatës Lartë, Gjykatës së Apelit, dhe Gjykatës së Shkallës të Parë, vendime që kanë cënuar rëndë liritë, Kushtetutën, ligjin procedural penal, por edhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, përsa i përket heqjes së lirisë, duke vendosur në masë shtrëguuese arrest në burg, ish-Presidentin e Republikës, ish-Kryeministrin dhe ish-Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, pa akuzë konkrete por vetëm me dyshime si person nën hetim.

I. MBI PRANUESHMËRINË DHE LEGJITIMIMIN E KËRKUESIT

Ratione personae – Kërkuesi legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, ku vendimet gjyqësore i kanë cenuar të drejtat e tij kushtetuese individuale. Për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

Shterimi i mjeteve juridike efektive - Kërkuesi ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ai i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese pasi ka ngritur para gjykatave të zakonshme pretendimet në formë dhe substancë.

Për të drejtën për t’u zgjedhur që ngrihet në ankimin kushtetues, edhe pse ajo nuk është ngritur në mënyrë të shprehur në këtë formë në ankim dhe rekurs, kërkuesi:

- i) ka ngritur si pretendim se e gjithë kjo është një inskenim për të përjashtuar atë nga procesi zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 11 majit 2025;
- ii) gjykatat e zakonshme nuk janë mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave të tilla me natyrë substanciale.

Ratione temporis – Kërkuesi legjitimohet dhe e plotëson edhe këtë kriter, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 27.02.2025 dhe ai i është komunikuar zyrtarisht në datën 16 prill 2025 datë nga e cila ecën afati 4-mujor për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Ratione materiae – Kërkuesi i plotëson edhe këtë kriter legjitimimi, pasi pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues janë me natyrë kushtetuese ndaj përbëjnë lëndë për Gjykatën Kushtetuese.

II. MBI THEMELIN E PRETENDIMEVE

A. PËR SHKELJE TË NENIT 25 TË KUSHTETUTËS DHE TË NENIT 3 TË KEDNJ

Rrethanat e arrestimit të Z. Ilir Metaj janë përshkruar në detaje më lart në paragrafët dhe janë bërë publikisht të njohura me anë të videove të botuara në media dhe në internet. Është e pakundërshtueshme që ndaj Z. Metaj në momentin e arrestimit të tij është ushtruar dhunë. Automjeti me të cilin udhëtonte është ndaluar në mes të rrugës forcërisht. Ai është nxjerrë me dhunë nga automjeti, nën kërcënimin e personave të maskuar dhe të armatosur rëndë. Ai është mbajtur forcërisht nga krahët, dhe i janë vënë prangat. Persona të maskuar i kanë kapur me dhunë kokën dhe duke e shtrënguar forcërisht në mes të rrugës e kanë futur në makinën e tyre, që ishte pa shenja policie. Gjithashtu janë vërejtur edhe goditje me grushta nga ana e policëve.

Në rrethanat konkrete nenit 3 i KEDNJ gjen plotësisht zbatim. Për më tepër, asnjë arsye, me shkrim ose me gojë, nuk i është dhënë në momentin e arrestimit. Në lidhje me standardet e zbatueshme në raste të tilla, GJEDNJ ka pranuar se Neni 3 nuk ndalon përdorimin e forcës nga oficerët e policisë gjatë një arrestimi. Megjithatë, ajo ka theksuar se përdorimi i forcës duhet të jetë proporcional dhe absolutisht i nevojshëm në rrethanat e çështjes. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të dihet në veçanti nëse ka arsye për të besuar se personi në fjalë do t'i rezistojë arrestimit, ose do të përpiqet të largohet, do të shkaktojë lëndime ose dëme, ose do të fshehë provat.

Dëshirojmë të theksojmë, në veçanti, se çdo përdorim i forcës fizike nga agjentët e shtetit kundër një personi, i cili nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore, shkel dinjitetin e tij njerëzor dhe, si e tillë, përbën shkelje të të drejtave të garantuara nga Neni 3 i Konventës¹.

Në vështrim të këtyre standardeve, pyetjet që shtrohen në vlerësimin e rrethanave konkrete të arrestimit të Z. Metaj janë:

¹ Shih, ndër shumë autoritete të tjera, për parimet e përgjithme të përpunuara nga GJEDNJ në situata të tilla, *Rehbock k. Sllovenisë*, nr. 29462/95, § 76, ECHR 2000-XII, botuar edhe në shqip, *Raninen k. Finlandës*, 16 dhjetor 1997, § 56, Raportet 1997-VIII, *Gutsanovi kundër Bullgarisë*, nr. 34529/10, §§ 113, 125-126, GJEDNJ 2013, *Douet k. Francës*, nr. 16705/10, §§ 28-30, 3 tetor 2013, *Bouyid k. Belgjikës* [GC], nr. 23380/09, §§ 88, 100 dhe 101, GJEDNJ 2015), *Ghedir dhe të tjerë k. Francës*, (nr. 20579/12, §§ 108-113, 16 korrik 2015 dhe *Boukrourou dhe të tjerë k. Francës*, nr. 30059/15, §§ 77-81, 16 nëntor 2017.

- A kishte kryer Z. Metaj ndonjë akt të dhunshëm dhe akuzat ndaj tij a lidheshin, në momentin e arrestimit dhe deri tani, me ndonjë akt dhune, qoftë ndaj individëve, qoftë ndaj autoriteteve?
- A kishte ndonjë arsye për të besuar se Z. Metaj do t'i rezistonte arrestimit?
- A kishte rrezik që Z. Metaj të largohej dhe nëse po, përse ky rrezik kishte lindur vetëm në tetor 2024 dhe nuk kishte ekzistuar përpara gjatë gjithë procedurës penale?
- A kishte rrezik që Z. Metaj të dëmtonte provat, sidomos kur bëhet fjalë për akuza mbi fakte që kanë ndodhur shumë vite më parë dhe për të cilat hetimi ishte i ditur dhe publik? Nëse po, cilat prova rrezikonte të dëmtonte Z. Metaj dhe si? A ka ndonjë analizë dhe raport në lidhje me këtë pikë që të mund të na paraqitet?
- A është mbajtur parasysh nga organet ligjzbatuese e kaluara politike dhe institucionale e Z. Metaj në planifikimin dhe organizimin e operacionit, dhe nëse fakti që Z. Metaj ka mbuluar pozicionet më të larta shtetërore në Republikën e Shqipërisë ka luajtur në favor apo kundër kësaj forme arrestimit. A ka një raport analitik nga institucionet ligjzbatuese mbi këtë pikë?
- A ishte vlerësuar që Z. Metaj të thirrej nga organet ligjzbatuese dhe masa e arrestit t'i komunikohet kur të paraqitet para tyre në mjediset institucionale, ashtu siç ishte paraqitur edhe shumë herë më parë? Përse kjo mundësi është përjashtuar dhe a ka ndonjë raport me arsyet përkatëse në lidhje me këtë analizë?
- A ishte përgatitur operacioni i arrestimit të Z. Metaj me kujdes nga organet ligjzbatuese dhe përse janë përjashtuar format e tjera të arrestit, si arresti në institucion, në shtëpi, në zyrë, etj, dhe në mjedise ku publiciteti i ekzekutimit të masës mund të shmangej?
- A ishte vlerësuar se përse ndërhyrja e forcave speciale, të maskuara dhe të armatosura rëndë ishte e nevojshme në rrethanat konkrete? Përse është përjashtuar arrestimi nga forca policore normale dhe a ka një raport të shkruar për këtë përfundim?

- A ishte planifikuar dhe organizuar operacioni në mënyrë të tillë që të shmangte aspektin publik dhe mediatik të arrestimit dhe përse çdo formë tjetër, në çdo rrethanë tjetër është konsideruar e papërshtatshme për arrestimin e Z. Metaj, sidomos duke pasur parasysh se ai ishte paraqitur disa herë pa asnjë incident pranë organeve?

Nuk besojmë se Gjykata Kushtetuese mund t’u japë përgjigje pozitive qoftë edhe njëherë nga pyetjet e mësipërme.

Gjithashtu, megjithëse rrethanat e arrestit të Z. Metaj janë përshkruar dhe ngritur nga kërkuesi përpara të gjitha organeve më të ulëta asnjëri prej tyre nuk ka marrë mundimin që të vlerësojë as pajtueshmërinë e këtyre masave me kriterin e ligjshmërisë sipas nenit 3 të KEDNJ dhe nenit 25 të Kushtetutës.

As nuk është bërë asnjë vlerësim i karakterit absolutisht të nevojshëm të mënyrës së arrestimit të Z. Metaj dhe as nuk është bërë asnjë hetim, as administrativ, as gjyqësor, mbi këtë pikë. Kjo kërkohet nga neni 3 KEDNJ marrë në aspektin procedural, ose nga neni 13 marrë së bashku me neni 3 KEDNJ².

Është a pakundërshtueshme, si e mbështetur në faktet që janë asgjë tjetër veçse proces-verbalet e marrjes në pyetje të Z. Metaj nga SPAK sa herë e kanë thirrur, që arrestimi i tij mund të kryhej me anë të një ftese të thjeshtë për t’u paraqitur në SPAK, ku pa pasur asnjë nevojë të thirreshin forcat speciale dhe të organizoheshin skena publike, Z. Metaj mund t’i komunikohet edhe masa e arrestit me burg, mundësisht duke iu bërë të njohura edhe të drejtat e tij si person në arrest.

I takon autoriteteve të shpjegojnë se përse një mënyrë e tillë procedimi nuk ishte e mundur. Ato nuk kanë dhënë asnjë shpjegim deri tani, edhe për faktin se gjykatat më të ulëta mesa duket nuk i kuptojnë saktë standardet e zbatueshme.

Në këtë drejtim, arsyetimi i Gjykatës së Lartë se pretendimet për dhunë mund të jenë objekt i një kallëzimi penal dhe nuk afektojnë procesin është arbitrar për sa kohë që pretendimi lidhet me mosrespektimin nga autoritetet shtetërore të të drejtave dhe garancive kushtetuese të individit, vjen haptazi në kundërshtim me standardet e GJEDNJ.

Është plotësisht e qartë që respektimi i standardeve të nenit 3 të KEDNJ në rastet e ushtrimit të dhunës kur kjo ngrihet përpara autoriteteve, nuk kërkon detyrimisht nisjen e një procesi penal.

² Shih ndër të tjera *Cestaro k. Italisë*, no. 6884/11, § 204..., 07/04/2015.

Për më tepër, neni 3, për shkak të karakterit absolut që ka, detyron çdo organ shtetëror të një vendi anëtar të KEDNJ, që të vlerësojë *ex officio* nëse rrethanat për të cilat ka ardhur në dijeni përbëjnë shkelje apo jo të kësaj dispozite.

Siç e ka thënë GJEDNJ:

“97. ...Neni 3 i Konventës krijon një detyrim pozitiv për të kryer një hetim zyrtar (Shih: Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, vendimi i datës 28 tetor 1998, Raportet 1998-VIII, f. 3290, § 102). Një detyrim i tillë pozitiv nuk mund të konsiderohet në parim si i kufizuar vetëm në rastet e keqtrajtimit nga agjentët e shtetit (shih M.C. kundër Bullgarisë, cituar më sipër, § 151).

Kështu, autoritetet kanë detyrimin të ndërmarrin veprime sapo të jetë paraqitur një ankesë zyrtare. Edhe në mungesë të një ankese të shprehur, duhet të ndërmerret një hetim nëse ka tregues të tjerë të mjaftueshëm të qartë se mund të ketë ndodhur torturë ose keqtrajtim. Një kërkesë për shpejtësi dhe dërgesë të arsyeshme është e nënkuptuar në këtë kontekst. Një reagim i shpejtë nga autoritetet në hetimin e akuzave për keqtrajtim në përgjithësi mund të konsiderohet si thelbësor në ruajtjen e besimit të publikut në ruajtjen e sundimit të ligjit dhe në parandalimin e çdo shfaqjeje të bashkëpunimit ose tolerancës ndaj akteve të paligjshme.

Toleranca nga autoritetet ndaj akteve të tilla nuk mund të mos e minojë besimin e publikut në parimin e ligjshmërisë dhe në ruajtjen e sundimit të ligjit nga Shteti (Shih: Batı dhe të Tjerë kundër Turqisë, nr. 33097/96 dhe 57834/00, § 136, ECHR 2004-IV (fragmente); Abdulsamet Yaman kundër Turqisë, nr. 32446/96, § 60, 2 nëntor 2004; dhe, mutatis mutandis, Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 46477/99, § 72, ECHR 2002-II). ”

Mesa duket Gjykata e Lartë ose nuk e ka të qartë standardin e zbatueshëm ose kërkon që të cenojë cilësinë e hetimit i cili, sipas GJEDNJ, duhet të jetë i shpejtë dhe i plotë, duke ndihmuar autoritetet përgjegjëse që t'i shmangen përgjegjësi për akte të ushtrimit të dhunës. Kujtojmë se:

“720 [...], jurisprudenca e Gjykatës [së Strasburgut] përcakton se duhet të ketë mbrojtje për një individ të arrestuar ose të ndaluar me dyshimin se ka kryer një vepër penale nëpërmjet kontrollit gjyqësor. Një kontroll i tillë shërben për të siguruar mbrojtje efektive kundër rrezikut të keqtrajtimit, i cili është në kulmin e tij në këtë fazë të hershme të ndalimit, dhe kundër abuzimit të pushteteve që u janë dhënë oficerëve të zbatimit të ligjit ose autoriteteve të tjera për ato që duhet

të jenë qëllime të kufizuara ngushtë dhe të ushtrohen në mënyrë strikte në përputhje me procedurat e përcaktuara.³

Përgjigja që jep Gjykata e Lartë në vendimin në lidhje me Z. Metaj, zhbën në vetvete qëllimin parësor sipas aspektit të parë të nenit 5 /3 KEDNJ, që një person i arrestuar si i dyshuar për kryerjen e një veprë penale duhet çuar menjëherë përpara një gjyqtari për të kontrolluar nëse ka pasur abuzim nga autoritetet gjatë arrestimit apo jo.

Nën dritën e kësaj jurisprudence të GJEDNJ, neni 28 /5 i Kushtetutës parashikon shprehimisht që:

“çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.”

Video dhe pamjet e arrestimit të Z. Metaj tregojnë qartë se asnjë kujdes për respektimin e dinjitetit të tij nuk është treguar – krejt e kundërta provohet nga pamjet që flasin vetë.

As Navalny në Rusi nuk është arrestuar në këtë mënyrë⁴.

(Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=rrdWW-M5za8>)

Siç u tha më lart, megjithëse mënyra e arrestit e Z. Metaj është ankimuar përpara të gjitha gjykatave më të ulëta, përveç faktit që është publikisht i njohur, asnjë hetim, në asnjë lloj forme, nuk ka filluar në lidhje me mënyrën e arrestit të Z. Metaj.

I takon Gjykatës Kushtetuese që t’u japë përgjigje të gjitha këtyre pyetjeve dhe të arrijë në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 25 të Kushtetutës dhe të nenit 3 KEDNJ, marrë, si në aspektin material, ashtu edhe në aspektin procedural.

B. PËR CENIMIN E SË DREJTËS PËR LIRI DHE SIGURI, TË GARANTUAR NGA NENI 31 I KUSHTETUTËS DHE NGA NENI 5 I KEDNJ

Aspekti procedural

1) Pretendimi për dhunën e forcave speciale në momentin e arrestimit dhe mungesën e komunikimit të akuzës janë pretendime që duhet të ngrihen me forcë:

³ Shih Ladent k. Polonisë no. 11036/03, §§ 71-76, 18/03/2008.

⁴ Shih GJEDNJ, *Navalny k. Rusisë*, [DHM] no. 29580/12, 36847/12, 11252/13, etj, 15/11/2018.

i) në kuadër të arbitraritetit dhe ligjshmërisë së vetë procedimit penal sipas nenit 5 të KEDNJ-së dhe të nenit 31 të Kushtetutës.

Aspekti institucional i cenimit të së drejtës për liri dhe siguri

Në vendimin e fundit të J.B. dhe të tjerë kundër Maltës, nr. 1766/23, 22/10/2024, GJEDNJ ka thënë se:

143. Kriteri i drejtësisë procedurale sipas nenit 5 / 4 nuk imponon një standard uniform dhe të pandryshueshëm që duhet të zbatohet pavarësisht nga konteksti, faktet dhe rrethanat. Megjithëse nuk është gjithmonë e nevojshme që një procedurë e nenit 5 / 4 të shoqërohet me të njëjtat garanci si ato të kërkuara sipas nenit 6 për çështjet gjyqësore ose civile, ajo duhet të ketë karakter gjyqësor dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për llojin e heqjes së lirisë në fjalë (**Shih**, ndër autoritetet e tjera, A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 3455/05, 203, KEDNJ 2009). Gjykata ka vendosur se pavarësia dhe paanshmëria janë elementë të rëndësishëm përbërës të nocionit të "gjykatës" në kuptimin e nenit 5/4 të Konventës. Për më tepër, një "gjykatë" duhet të jetë gjithmonë "e themeluar me ligj", në të kundërt se do t'i mungonte legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar çështje individuale (**Shih**: Lavents kundër Letonisë, nr. 58442/00, 81, 28 nëntor 2002). Parimet e përgjithshme në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e një gjykate, për qëllimet e nenit 6 të Konventës, u përcaktuan në rastin Ramos Nunes de Carvalho e Sá v. Portugalia ([GC], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, 144-50, 6 nëntor 2018) dhe Gjykata ka konsideruar se këto parime, të zhvilluara në kontekstin e nenit 6/1 të Konventës, zbatohen në mënyrë të barabartë për nenin 5/4 (**Shih**: Ali Osman Özmen kundër Turqisë, nr. 42969/04, 87, 5 korrik 2016, dhe Baş kundër Turqisë, nr. 66448/17, 267, 3 mars 2020).

144. Në veçanti, për të përcaktuar nëse një tribunal mund të konsiderohet si "i pavarur" në kuptimin e nenit 6/1, duhet të merren parasysh, ndër të tjera, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe mandati i tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe çështja nëse organi paraqet një pamje pavarësie (**Shih**: Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 shkurt 1997, 73, Reports of Judgments and Decisions 1997-I, dhe Tsanova-Gecheva kundër Bullgarisë, nr. 43800/12, 106, 15 shtator 2015).

Gjykata vëren se nocioni i ndarjes së pushteteve midis ekzekutivit dhe gjyqësorit ka marrë një rëndësi në rritje në praktikën e saj gjyqësore (**Shih**: Stafford kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 46295/99, 78, KEDNJ

2002-IV). Megjithatë, as neni 6 dhe as ndonjë dispozitë tjetër e Konventës nuk kërkon që shtetet të respektojnë ndonjë koncept teorik kushtetues në lidhje me kufijtë e lejuar të ndërveprimit të pushteteve (**Shih:** Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës [GC], nr. 39343/98 dhe 3 të tjerë, § 193, KEDNJ 2003-VI).

145. Gjykata gjithashtu ka vendosur se ekziston një marrëdhënie shumë e ngushtë midis kërkesave të "pavarësisë", "paanshmërisë" dhe "gjykatës së themeluar me ligj", dhe se një organ gjyqësor që nuk plotëson kërkesat e pavarësisë – në veçanti nga ekzekutivi – dhe të paanshmërisë nuk mund të karakterizohet as si një "gjykatë" për qëllimet e nenit 6 § 1 (**Shih:** Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës [GC], nr. 26374/18, §§ 231-32, 1 dhjetor 2020).

Në këtë kontekst, "pavarësia" i referohet pavarësisë së nevojshme personale dhe institucionale që kërkohet për vendimmarrje të paanshme, dhe kështu është një parakusht për paanshmëri. Ai karakterizon (i) një gjendje shpirtërore, e cila tregon papërshkueshmërinë e një gjyqtari ndaj presionit të jashtëm si çështje e integritetit moral dhe (ii) një sërë marrëveshjesh institucionale dhe operacionale – që përfshijnë një procedurë me të cilën gjyqtarët mund të emërohen në një mënyrë që siguron pavarësinë e tyre dhe kriteret e përzgjedhjes bazuar në merita – të cilat duhet të ofrojnë mbrojtje kundër ndikimit të panevojshëm dhe/ose diskrecionit të papenguar të pushteteve të tjera shtetërore, si në fazën fillestare të emërimit të një gjyqtari ashtu edhe gjatë ushtrimit të detyrave të tij ose të saj (po aty, 234).

Ky është i fundit nga një seri vendimesh ku Gjykata konfirmon se për qëllimet e nenit 5/4, një gjykatë do të kuptohet se ka karakteristika të ngjashme me nocionin e një gjykate sipas nenit 6/1 të KEDNJ.

Gjykata ka nënvizuar se pavarësia dhe paanshmëria janë elementë të rëndësishëm përbërës të nocionit të "gjykatës" në kuptimin e nenit 5/4.

Ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe pyetja nëse organi paraqet një pamje pavarësie janë komponentë të pavarësisë dhe paanshmërisë së kërkuar. Gjykata gjithashtu ka nënvizuar se duhet të ketë masa mbrojtëse kundër ndikimit të papërshtatshëm dhe/ose diskrecionit të papenguar të pushteteve të tjera shtetërore, si në fazën fillestare të emërimit të gjyqtarit ashtu edhe gjatë ushtrimit të detyrave të tij.

Në të njëjtën linjë, GJEDNJ-ja ka deklaruar se:

*"Rregulla të tilla, ..., duhet të jenë të një natyre të tillë që "ato nuk mund të shkaktojnë dyshime të arsyeshme, në mendjet e individëve, në lidhje me papërshtueshmërinë e gjyqtarëve të interesuar ndaj faktorëve të jashtëm dhe për neutralitetin e tyre në lidhje me interesat para tyre, pasi të emërohen si gjyqtarë"*⁵

Komiteti i të Drejtave të Njeriut gjithashtu ka deklaruar se:

*"E drejta për barazi para gjykatave dhe gjykatave dhe për një gjykim të drejtë është një element kyç i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe shërben si një mjet procedural për të mbrojtur sundimin e ligjit. Neni 14 i Paktit synon të sigurojë administrimin e duhur të drejtësisë dhe për këtë qëllim garanton një numër të drejtash specifike."*⁶

Kërkuesi Z. Ilir Metaj pretendon se sistemi ligjor shqiptar nuk ofron garanci të tilla dhe se gjyqtarët e gjykatave speciale që vendosën dhe shqyrtuan masat e arrestit ndaj tij nuk janë të pavarur dhe as të paanshëm në sytë e një vëzhguesi objektiv.

Kjo është për shkak të dispozitave të mëposhtme legislative dhe institucionale në sistemin ligjor shqiptar.

Kërkuesi është i ndërgjegjshëm që pretendime të ngjashme janë shqyrtuar dhe hedhur poshtë nga Gjykata Kushtetuese me vendimin 81/24.

Megjithatë kërkuesi e ngre këtë pretendim edhe për arsye shterimi, edhe për t'i sjellë në vëmendje Gjykatës Kushtetuese standardet e zbatueshme, në rast të mundësisë për një rishikim të pozicionit të saj të mëparshëm.

Sipas neneve 135/4 të Kushtetutës dhe neneve 42, 48-51 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar", prokurorët dhe gjyqtarët e gjykatave speciale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë nën mbikëqyrjen e një hetuesi.

- **Mbikëqyrja sistematike dhe sistematike e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjykatave speciale**

⁵ Aktgjykimi i GJDHE (Dhoma e Madhe) i 2 marsit 2021, në çështjen C 824/18, A.B., C.D., E.F., G.H., I.J. kundër Krajowa Rada Sądownictwa, § 123, ECLI:EU:C:2021:153.

⁶ Komiteti i të Drejtave të Njeriut, Komenti i Përgjithshëm Nr. 32 (2007) "Neni 14: E drejta për barazi para gjykatave dhe gjykatave dhe për një gjykim të drejtë", UN Doc. KPPR/C/GC/32, 23 gusht 2007, § 2.

Pavarësisht se Gjykata Kushtetuese shprehet se mbikëqyrja e gjyqtarëve të gjykatave speciale nuk është e vazhdueshme, na duhet të theksojmë se nocioni i monitorimit të vazhdueshëm të një personi, në këtë rast të një gjyqtari, nënkupton që në çdo rast që autoriteti përgjues vendos të monitorojë, mund ta bëjë këtë pa asnjë pengesë dhe pa iu kufizuar konkretisht me një vendim gjyqësor të arsyetuar mënyra dhe kohëzgjatja.

Në fakt asnjë monitorim i vazhdueshëm në botë, nuk është në gjendje që të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme një person pafundësisht.

Pra nocioni i vazhdimësisë në pretendimin tonë lidhet me diskrecionin absolut – lexo arbitraritet sipas kuptimit të së drejtës evropiane - për të përgjuar një person, në këtë rast gjyqtarët e gjykatave speciale, sa herë që SPAK ose BKH të dojë.

Përgjimi, i konfirmuar zyrtarisht edhe i një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese është provë e fortë në ushtrimin e këtij arbitrariteti nga ana e SPAK dhe BKH.

Në këtë kuptim, gjyqtarët e gjykatave speciale, duke hequr dorë shprehimisht nga e drejta për të mos u përgjuar në përputhje me garancitë që Kushtetuta dhe KEDNJ i garantojnë çdo individ tjetër, ashtu edhe avokatëve në një proces, i nënshtrohen një kontrolli diskrecionar, pa garanci gjatë ushtrimit të detyrës, dhe një presioni të paparë në asnjë vend anëtar të KEDNJ.

Nenet 135 § 4 të Kushtetutës dhe 48 (Heqja dorë nga të drejtat si kërkesë për caktim, punësim dhe qasje në informacion) i Ligjit Nr. 95/2016 e formalizojnë qartë këtë ndërhyrje.

- **Kush e kontrollon mbikëqyrjen dhe si?**

Sipas Nenit 42 (Zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen) të Ligjit Nr. 95/2016

“1. Zyrtari përgjegjës për mbikëqyrje është hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit me të paktën pesë vjet përvojë si oficer i policisë gjyqësore.”

Sipas nenit 51 të të njëjtit ligj një hetues i BKH vendos se kë, kur dhe si do përgjojë dhe si dhe për sa kohë do ruajë të dhënat, pa asnjë lloj mbikëqyrje nga një organ i pavarur nga palët dhe nga organet e ndjekjes penale.

Të nderuar gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Komisioni i Venecias në Opinionin e tij nr. 824/2015 "MBI PROJEKT-NDRYSHIMET E RISHIKUARA KUSHTETUESE PËR GJYQËSORIN", 15 janar 2016, shprehu dyshime serioze në lidhje me këtë sistem të mbikëqyrjes së përhershme të gjyqtarëve. Paragrafi 51 i Opinionit thotë:

51. Formulimi i përdorur në pjesën e dytë të fjalisë së dytë të nenit 135 f. 3, që i referohet detyrimit të gjyqtarëve të specializuar dhe anëtarëve të familjes së tyre për t'iu nënshtruar "rishikimeve periodike të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikacionit", duket të jetë tepër i gjerë. Ndërsa rishikimi i llogarive financiare është një mjet specifik dhe efektiv për monitorimin e pasurive dhe të ardhurave që duhet të deklarohen nga një gjyqtar, kryerja e një "shqyrtimi të telekomunikacionit" të një gjyqtari dhe veçanërisht të familjarëve të tij, në mungesë të garancive të duhura, do të çonte në një kufizim të panevojshëm të së drejtës së tyre për privatësi.

Komisioni i Venecias kupton se madhësia e problemit të korrupsionit në Shqipëri kërkon masa të veçanta mbikëqyrjeje në lidhje me operacionet financiare të mbajtësve të zyrave gjyqësore dhe prokuroriale dhe se këta të fundit duhet të jenë të përgatitur për t'u ekspozuar më shumë ndaj transparencës dhe kontrolleve shtesë.

Megjithatë, Kushtetuta nuk duhet t'u japë një letër të bardhë shërbimeve të sigurisë për të përgjuar të gjitha komunikimet e një gjyqtari/prokurori të specializuar dhe, në veçanti, të familjarëve të tyre. Çdo "rishikim i tillë i telekomunikacionit" duhet të shoqërohet me garanci procedurale adekuate dhe efektive, duke mbrojtur ata persona nga abuzimet dhe të përshkruhet qartë në ligj; Në veçanti, duhet të ketë një autorizim gjyqësor të bazuar në një dyshim të arsyeshëm se personi në fjalë është i përfshirë në disa aktivitete të paligjshme.

Përgjimi i komunikimeve të anëtarëve të familjes pa pëlqimin e tyre paraprak ose në mungesë të miratimit gjyqësor bazuar në disa fakte specifike dhe duke krijuar një dyshim të arsyeshëm për një aktivitet kriminal përbën qartë një ndërhyrje serioze në privatësinë e tyre. Ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët e specializuar mund të heqin dorë nga disa nga të drejtat e tyre të privatësisë, kjo heqje dorë mund të mos mbulojë të gjithë të afërmit e tyre dhe ligji duhet të parashikojë një mekanizëm të veçantë për të mbrojtur interesat e privatësisë së atyre që mund të preken aksidentalisht nga masat e mbikëqyrjes.

Gjykata Kushtetuese, në pikat 68-73 të vendimit 81/24, e analizon këtë problem vetëm nga këndvështrimi i garancive në fazën e procedimit eventual disiplinor ndaj gjyqtarëve.

Kjo qasje nuk pasqyron praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së se gjyqtarët duhet të jenë të lirë nga çdo presion nga degët e tjera të qeverisë, si dhe nga palët⁷

Kjo është veçanërisht e mprehtë, si në rastin konkret, ku është prokuroria që monitoron çdo moment të jetës profesionale të gjyqtarëve.

Nuk ka asnjë garanci në këtë sistem që SPAK të mos monitorojë dhe regjistrojë diskutimet mes gjyqtarëve dhe ndihmësve të tyre, që mund të jenë edhe me mjete elektronike, siç është e-mail ose telefon.

Ky sistem mbikëqyrjeje institucionalizon një presion të rregullt nga një degë tjetër e Qeverisë, e cila është gjithashtu pala tjetër në procedurën përpara gjykatave të posaçme, përpara Gjykatës së Lartë dhe përpara Gjykatës Kushtetuese.

Për më tepër kjo palë që mbikëqyr gjyqtarët ka kërkuar masat e paraburgimit kundër kërkuarit, ligjshmëria dhe proporcionaliteti i të cilave po kontrollohen nga gjykatat. Në këto kushte, *"dyshimet e aplikantit për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatës që trajtoi çështjen e tij janë objektivisht të justifikuara"*.⁸

Referenca e Gjykatës Kushtetuese për garancitë gjatë procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve të gjykatave speciale nuk është shqetësim i parashtruesit të kërkesës. Në çdo rast Gjykata Kushtetuese ftohet të kujtojë se zyrtarët policorë, në bazë të atyre të dhënave që mbledhin gjatë mbikëqyrjes mund të informojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe më pas të nisin procedurën disiplinore ose mund të informojnë edhe prokurorët e SPAK për fillimin e procedimeve penale (përkatësisht nenet 42 § 9 dhe 51 § 3 të Ligjit 95/2016).

Prandaj, presioni ndaj gjyqtarëve të gjykatave speciale nga një mbikëqyrje e vazhdueshme, e cila nuk bazohet në asnjë dyshim dhe nuk miratohet nga gjyqtari dhe mund të shkaktojë procedime disiplinore ose penale është e përhershme pasi rrezikon seriozisht pamjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së tyre.

⁷ Për vlerësimin e pavarësisë dhe paanshmërisë, Gjykata ka identifikuar si të nevojshme "... faktorë si mënyra e emërimit të anëtarëve të organit, kohëzgjatja e mandatit të tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe pyetja nëse organi paraqet një pamje pavarësie" (Maktouf dhe Damjanović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës [G.C.], § 49, 18.7.2013).

⁸ Shih *Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22107/93, § 80, 25/02/1997.

Në përgjigje të argumentit të Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi pretendon se çdo gjyqtar nën një mbikëqyrje të tillë do të preferonte të ndiqte qëndrimin e SPAK sesa të rrezikonte edhe mundësinë më të vogël të procedimit disiplinor apo penal.

Nëse Gjykata Kushtetuese gjen garancitë kundër një mbikëqyrjeje të tillë në nivelin e procedimeve disiplinore, a do të supozojmë, me arsyetim të kundërtën, se legjislacioni shqiptar ka dhënë garanci shumë më të mëdha dhe specifike në rastet e mbikëqyrjes së avokatëve dhe individëve, sepse në rastet e tyre nuk ka garanci në rastet e procedimit disiplinor apo penal? Ata gjithashtu do të dëgjohen nga gjyqtarë të pavarur. Prandaj, arsyetimi i gjykatës Kushtetuese në vendimin 81/24 nuk qëndron.

Rasti i kërkuesit është evidencë juridike – pala tjetër në procedurë ka të drejtë të vëzhgojë komunikimin e gjyqtarëve të posaçëm dhe familjarëve të tyre.

Mund ta bëjë këtë pa ndonjë kontroll paraprak ose të mëvonshëm nga gjyqtari.

Megjithëse Gjykata Kushtetuese është në dijeni të paralajmërimit të bërë nga Komisioni i Venecias në opinionin e tij të lartpërmendur, paralajmërimi i cituar në pikën 71 të vendimit 81/24⁹, hedh poshtë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, pa dhënë përgjigje nëse procesi i mbikëqyrjes kontrollohet nga gjyqtari apo jo.

Përkundrazi, nenet 42, 49 dhe 51 të ligjit 95/2016 nuk parashikojnë në asnjë moment që ky proces mbikëqyrjeje të autorizohet ose kontrollohet nga gjyqtari.

Asnjë nga të ashtuquajturat garanci që Gjykata Kushtetuese përmend në pikën 72 të vendimit 81/24 nuk i përgjigjet kriterëve që Gjykata e Strasburgut dhe Komisioni i Venecias i konsiderojnë garanci kundër abuzimeve në rastet e mbikëqyrjes.

Kjo është veçanërisht akute kur gjyqtarët janë subjekt i ndërhyrjeve të tilla.

Në praktikën e saj gjyqësore për masat sekrete të mbikëqyrjes, GJEDNJ ka zhvilluar masat minimale të mëposhtme që duhet të përcaktohen në ligj për të shmangur abuzimet me pushtetin¹⁰:

- i) natyrën e veprave penale që mund të shkaktojë një urdhër përgjimi;
- ii) një përkufizim të kategorive të njerëzve që mund të përgjohen telefonat e tyre;

⁹ Në vendimin e Komisionit të Venecias të cituar nga Gjykata Kushtetuese thuhet se sistemi i mbikëqyrjes i futur me ligjin 95/2016 "... duhet të shoqërohen me garanci procedurale adekuate dhe efektive, që i mbrojnë ata persona nga abuzimet dhe të përshkruhen qartë në ligj; në veçanti, duhet të ketë një autorizim gjyqësor të bazuar në dyshimin e arsyeshëm se personi në fjalë është i përfshirë në disa aktivitete të paligjshme..."

¹⁰ Shih *Amann kundër Zvicrës* [GC], nr. 27798/95, §§ 56-58, KEDNJ 2000 II, *Prado Bugallo kundër Spanjës*, nr. 58496/00, § 30, 18 shkurt 2003; *Weber dhe Saravia kundër Gjermanisë (dhjetor)*, nr. 54934/00, § 95, KEDNJ 2006-XI.

- iii) një kufi në kohëzgjatjen e përgjimit telefonik;
- iv) procedurën që duhet ndjekur për ekzaminimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave të marra;
- v) masat paraprake që duhen marrë gjatë komunikimit të të dhënave me palët e tjera;
- vi) dhe rrethanat në të cilat regjistrimet mund ose duhet të fshihen ose shkatërrohen;
- vii) autorizimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit a posteriori¹¹.

Sistemi shqiptar i prezantuar me Ligjin 95/2016 përcakton disa masa mbrojtëse në lidhje me pikat (ii), (iv) dhe (vi). Madje edhe në lidhje me pikat (iv) dhe (vi) masat mbrojtëse nuk janë të plota.

Por sistemi shqiptar dështon në raport me të gjitha pikat e tjera. Për shembull, në lidhje me pikën (i) më sipër, oficerët e policisë së BKH-së gjithashtu mund të raportojnë sjelljen e pahijshme etike të gjyqtarëve ose prokurorëve tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë¹². Kjo do të thotë se shtrirja e mbikëqyrjes është praktikisht e pakufizuar. Kjo është shumë më problematike, sesa sistemi në Hungari, ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së¹³.

Sistemi shqiptar i themeluar me Ligjin 95/2016 nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga Gjykata në lidhje me përgjimet me shumicë. Në *Big Brother Watch dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁴, Gjykata vuri në dukje se sistemi britanik:

"nuk përmbante masa mbrojtëse të mjaftueshme "nga fundi në fund" për të ofruar garanci adekuate dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimit. Në veçanti, ajo ka identifikuar mangësitë themelore të mëposhtme në regjim: mungesa e autorizimit të pavarur, dështimi për të përfshirë kategoritë e përzgjedhësve në aplikimin për një urdhër dhe dështimi për t'iu nënshtruar përzgjedhësve të lidhur me një individ në autorizim të brendshëm paraprak (shih paragrafët 377-382 më lart).

¹¹ Shih gjithashtu masat mbrojtëse për përgjimin në masë të komunikimeve, gjë që mund të argumentohet se është rasti këtu, *Big Brother Watch dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], 2021, § 361, dhe *Centrum för rättvisa kundër Suedisë* [GC], 2021, § 275.

¹² Neni 42 § 9 i Ligjit 95/2016.

¹³ Shih Szabó dhe Vissy kundër Hungarisë, nr. 37138/14, §§ 52-89, 12/01/2016.

¹⁴ Shih *Big Brother Watch dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [GC] nr. 58170/13, 62322/14, 24960/15, § 425, 25/05/2021

Në sistemin shqiptar hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimeve ka ligjërisht dhe realisht diskrecion të plotë në fillimin dhe kryerjen e mbikëqyrjes, siç parashikohet nga neni 42 i ligjit 95/2016¹⁵.

Në veçanti, nuk ka autorizim nga një gjyqtar për mbikëqyrjen dhe në këtë pikë sistemi shqiptar dështon edhe në krahasim me sistemin rus¹⁶.

Nuk ka as *një kontroll të mëvonshëm* nga ndonjë gjykatës se si janë mbledhur, ruajtur dhe përdorur këto të dhëna. Mbikëqyrja e parashikuar me Ligjin 95/2016 nuk kërkon as autorizimin e prokurorit, gjë që në rastin konkret do të ishte veçanërisht problematike, pasi prokurorët janë pala tjetër në procedurë.

Prandaj, mbikëqyrja mbulon të gjitha komunikimet elektronike dhe të tjera të gjyqtarëve specialë, përfshirë familjet e tyre. Mbikëqyrja është e pakufizuar në kohë dhe hapësirë, pa ndonjë arsye specifike dhe nuk miratohet *a priori* ose shqyrtohet *a posteriori* nga asnjë gjykatë në lidhje me ligjshmërinë ose proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje.

Dallimi midis periodikut dhe të përhershëm që Gjykata Kushtetuese përpiqet të bëjë nuk qëndron.

Ideja është që në çdo moment gjatë karrierës së tyre, me një vendim të marrë nga oficerët e policisë, gjyqtarët mund të jenë nën mbikëqyrje.

Mbikëqyrja vendoset, kryhet, regjistrohet dhe ruhet në diskrecion të plotë nga oficerët e policisë që janë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe përzgjidhen nga ky i fundit për të kryer këtë mbikëqyrje.

Oficerët e policisë mund të vëzhgojnë komunikimet e gjyqtarëve sa herë që duan dhe duke ndjekur një periodicitet ata vendosin pa asnjë kontroll.

Kjo situatë mjafton për të konkluduar se gjyqtarët e gjykatave speciale i nënshtrohen mbikëqyrjes që nuk paraqet asnjë garanci, as ligjore dhe as institucionale, dhe nuk mund të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Sistemi shqiptar ka më shumë besim tek oficerët e policisë në luftën e tij kundër korrupsionit sesa tek gjyqtarët, edukimi, përzgjedhja, emërimi publik dhe pavarësia e të cilëve janë qartësisht më të besueshme se ai i përzgjedhjes së oficerëve të panjohur të policisë.

¹⁵ Shih *Roman Zakharov kundër Rusisë*, [GC], nr. 47143/06, § 230, 04/12/2015.

¹⁶ Shih *Roman Zakharov kundër Rusisë*, [GC], nr. 47143/06, §§ 257-267, 04/12/2015.

Në të gjitha sistemet që GJEDNJ ka pasur rastin të vlerësojë në lidhje me mbikëqyrjen sekrete, shqetësimi ka qenë se veprimet e autoriteteve policore do të kufizohen dhe kontrollohen nga gjyqtarë të pavarur.

Sistemi shqiptar është përmbys – oficerët e policisë mbikëqyrin gjyqtarët.

Një mbikëqyrje e tillë e vazhdueshme ngre dyshime serioze për pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave speciale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Nuk është e mundur që një person i cili, sipas nenit 42 të Ligjit Nr. 95/2016, vihet nën një mbikëqyrje të tillë nga një hetues anonim, i cili në thelb është një oficer policie, të jetë autoritet gjyqësor që plotëson kushtet e pavarësisë të kërkuara nga nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së. Veçanërisht, hetuesi është pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila është në varësi të Prokurorisë së Posaçme, e cila është organi që ka kërkuar masat shtrënguese në fjalë dhe që i mbron ato para gjykatës. Hetuesi që anketon gjyqtarët e GJKKO dhe GJKKO e Apelit sipas nenit 42 të Ligjit Nr. 95/2016, është pjesë e strukturës së organit të prokurorisë, gjegjësisht pala, veprimet e së cilës janë kontestuar para gjyqtarëve të posaçëm dhe janë shqyrtuar prej tyre.

Për ta përmbledhur, një mbikëqyrje e pakufizuar, e përhershme¹⁷, e pakontrolluar, pa asnjë vështrim dyshimi, ushtrohet ndaj gjyqtarëve të gjykatave speciale, nga Byroja Kombëtare e Hetimit, e cila është pala tjetër në këto procedura.

Kështu, struktura që heton parashtruesin, ka nën mbikëqyrje të plotë dhe të pakufizuar edhe gjyqtarët që vendosin për ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e të gjitha masave, përfshirë paraburgimin në këtë rast, të marra në kuadër të hetimit të parashtruesit të kërkesës. Duke pasur parasysh një regjim të tillë, është e lehtë të konkludohet se sekret i komunikimeve dhe diskutimeve midis gjyqtarëve të gjykatave speciale dhe stafit të tyre, të cilët janë elementë themelorë të mbrojtur ligjërisht të një gjykimi të drejtë, rrezikohet seriozisht¹⁸. Këta gjyqtarë nuk janë të rrethuar me garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre objektive.¹⁹

Siç e përmendëm edhe më lart, regjimi i mbikëqyrjes së gjyqtarëve të gjykatave speciale, nuk respekton garancitë e parashikuara për përgjimin e komunikimeve nga legjislacioni penal shqiptar. Krahësimi i thjeshtë me dispozitat e Kodit të Procedurës

¹⁷ Gjykata Kushtetuese thotë se mbikëqyrja është periodike. Kjo nuk ndryshon asgjë në pretendimin se në çdo moment në kohë, që do të thotë potencialisht ose diskrecionarisht përgjithmonë, gjyqtarët e gjykatave speciale janë nën kërcënimin e mbikëqyrjes nga një oficer policie.

¹⁸ Shih *Dudchenko kundër Rusisë*, nr. 37717/05, § 105, 7/11/2017.

¹⁹ Shih *Piersack kundër Belgjikës*, vendimi i 1 tetorit 1982, Seria A nr. 53, f. 14-15, § 30, dhe *Grievies kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC]*, nr. 57067/00, § 69, 16 dhjetor 2003

Penale që rregullojnë përgjimin e komunikimeve të individëve privatë²⁰, zbulon se në rastin e fundit jo vetëm që mbikëqyrja e bisedave nuk është automatike dhe e përhershme²¹, por gjithashtu duhet të autorizohet nga gjyqtari dhe ka të drejtë apeli²². Këto garanci nuk ofrohen për gjyqtarët e gjykatës speciale shqiptare.

GJEDNJ së fundmi ka konfirmuar në vendimin *Pietrzak dhe Bychaëska-Siniarska dhe të tjerë kundër Polonisë*²³, rëndësinë e veçantë që i jepet mbrojtjes nga mbikëqyrja arbitrare e aktorëve në sistemin e drejtësisë. Nëse ajo çështje merrej me mbikëqyrjen e avokatëve, çështja merr shumë më tepër rëndësi, për qëllimin e një gjykimi të drejtë, në rastet e mbikëqyrjes së gjyqtarëve. Kjo është veçanërisht akute nëse autoriteti që kryen procesin e mbikëqyrjes dhe ruajtjes është palë në procedurën penale para gjyqtarëve që janë nën mbikëqyrje.

Është e lehtë të theksohet se neni 52 i KPP-së shqiptare ofron më shumë garanci në rastet e kërkimeve dhe përgjimit të komunikimeve të avokatëve mbrojtës sesa ato që Kushtetuta dhe Ligji 95/2016 parashikojnë për gjyqtarët e gjykatave speciale²⁴.

Do të ishte e paimagjinueshme që një sistem juridik i rregulluar nga sundimi i ligjit ku gjyqësori është garantuesi përfundimtar, të sigurojë garanci specifike thelbësore dhe procedurale për avokatët dhe individët privatë, për qëllime të procesit të rregullt, dhe të mos ofrojë garanci të tilla për gjyqtarët!

²⁰ Shih nenet 221-226 të KPP.

²¹ Shih nenin 221 § 1 të KPP

²² Shih nenin 222 §§ 1, 3, 4, 5, 6 dhe nenin 222/a KPP.

²³ Shih *Pietrzak dhe Bychawska-Siniarska dhe të tjerë kundër Polonisë*, nr. 72038/17, 25237/18, §§ 118-123, 28/05/2024.

²⁴ Neni 52 (Garancitë për mbrojtjen) i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me nenin 38 të Ligjit Nr. 35/2017 të 30.03.2017 thotë:

1. Kqyrjet dhe kontrollimet në zyrën e mbrojtësit lejohen vetëm:

a) kur ai ose persona të tjerë që zhvillojnë vazhdimisht veprimtari në të njëjtën zyrë janë të pandehur dhe vetëm brenda qëllimeve për të provuar veprën penale që u atribuohet;

b) për të zbuluar gjurmët ose provat materiale të veprës penale ose për të kërkuar sende a persona të përcaktuar në mënyrë të posaçme.

c) në rastet kur mbrojtësi ndodhet në kushtet e flagrancës ose ndjekjes, sipas paragrafit 1, të nenit 298, të këtij Kodi.

2. Para se të bëjë këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin në zyrën e një mbrojtësi, organi procedues njofton këshillin drejtues të dhomës së avokatëve me qëllim që një anëtar i tij të ketë mundësinë që të jetë i pranishëm në veprimet. Përveç rasteve të flagrancës, organi procedues shtyn këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin deri në mbërritjen e anëtarit të caktuar, por jo më shumë se 2 orë pasi është informuar Dhoma e Avokatisë. Në çdo rast një kopje e aktit i dërgohet këshillit drejtues të dhomës së avokatëve.

3. Kqyrjet, kontrollimet dhe sekuestrimet në zyrat e mbrojtësve, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të paragrafit 1, të këtij neni, i bën gjyqtari personalisht, kurse gjatë hetimeve paraprake ato i bën prokurori në bazë të një vendimi autorizues të gjykatës.

4. Nuk lejohet përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit të mbrojtësve dhe të asistentëve të tyre, as ndërmjet njëri-tjetrit dhe as me personat që ata mbrojnë.

5. Ndalohet çdo formë kontrolli e korrespondencës ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

6. Rezultatet e këqyrjeve, të kontrollimeve, të sekuestrimeve, të përgjimeve të bisedave ose të komunikimit, të kryera në shkelje të dispozitave të mësipërme, nuk mund të përdoren”

Ky krahasim është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se dispozitat përkatëse të Ligjit 95/2016 janë një shkelje flagrante e vetë nocionit të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të GJKKO dhe GJKKO e Apelit. Këta gjyqtarë, nën mbikëqyrje apriori dhe të pakufizuar dhe pa asnjë garanci procedurale, nuk mund të ofrojnë garanci pavarësie dhe paanshmërie për individët që paraqiten para tyre.

Në rrethana të tilla, kur gjyqtarët që vendosën masat e paraburgimit kundër kërkuesit janë nën mbikëqyrjen e strukturave në varësi të palës tjetër në procedurë, ka arsye legjitime që kërkuesi Z. Metaj, të ketë bindjen se këtyre gjyqtarëve u mungon pavarësia dhe paanësia, dhe kjo bindje mund të konsiderohet objektivisht e justifikuar (**Shih:** *Wettstein, kundër Zvicrës*, nr. 33958/96, § 44, KEDNJ 2000-XI, dhe *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, 7 gusht 1996, § 58, Reports of Judgments and Decisions 1996-III). Për këto arsye kërkuesi pretendon se ka shkelje të nenit 5 §§ 1 dhe 4 në këtë rast.

(**Shih:** <https://www.syri.net/politike/677566/altin-dumani-pranon-ekzistencen-e-republikes-se-prokuroreve-afermendsh-qe-gjykata-vendos-sic-duam-ne/>)

Aspekti substancial i cenimit të lirisë personale

Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, të cilat parashikohen në mënyrë të detajuar në KPP. Neni 27, pika 2, i Kushtetutës parashikon rastet e kufizimit të lirisë personale, ndërsa shkronja “c” e kësaj dispozite kushtetuese parashikon si të tilla ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen nga individit të një veprë penale, parandalimin e kryerjes prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj.

Kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Si të tilla, këto procedura duhet të respektojnë garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, përfshirë standardin e arsyetimit të vendimit. (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 21, datë 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se “*dyshimet e arsyeshme*” për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Këto fakte nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, të cilat i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal.

Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individi, Gjykata mban në konsideratë kontekstin e përgjithshëm të fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimin Nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

GJEDNJ-ja ka identifikuar disa shkaqe që konsiderohen të pranueshme për të justifikuar paraburgimin:

a) rreziku që i dyshuari/akuzuari në qoftë se do të lihej i lirë do të largohej dhe nuk do paraqitej përpara gjykatës;

b) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë do të ndërmernte veprime për të penguar dhënien e drejtësisë;

c) rreziku që i dyshuari/akuzuari nëse do të lihej i lirë do të kryente vepra penale të tjera (**Shih:** *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë, datë 05.07.2016, § 88; Tiron kundër Rumanisë, datë 07.04.2009, § 37; Smirnova kundër Rusisë, datë 24.07.2003, § 59*).

Për sa i përket rrezikut të largimit, sipas GJEDNJ-së, ai duhet të vlerësohet nën dritën e faktorëve të tillë që lidhen me personalitetin (e të akuzuarit/pandehurit), banesën, punën, pasuritë, lidhjet familjare dhe çdo lidhje tjetër me vendin ku zhvillohet procesi penal (**Shih:** *Becciev kundër Moldavisë, datë 04.10.2005, §§ 58-59*). Rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale është një ndër shkaqet që mund të bindin autoritetet gjyqësore që të vendosin dhe lënë në paraburgim një të dyshuar. Megjithatë është e nevojshme që rreziku të jetë i besueshëm nën dritën e rrethanave të çështjes, historikut dhe personalitetit të të dyshuarit.

Dënimet e mëparshme mund të shërbejnë si shkas për të besuar në mënyrë të arsyeshme se i akuzuari mund të kryejë vepra penale të tjera (**Shih:** *Selçuk kundër Turqisë, datë 10.01.2006, § 34; Matznetter kundër Austrisë, 10.11.1969, § 9*).

Sipas GJEDNJ-së, këto rreziqe duhet të tregohen me argumente thelbësore dhe arsyetimi i autoriteteve për këto çështje nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip (**Shih:** *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, datë 28.11.2017, § 222).

Gjithashtu, në çështjen *Gëllçi k. Shqipërisë*, No. 5468/23 25.2.2025 GJEDNJ është shprehur se:

“22. Sa i përket bazave për ndalimin e aplikantit, gjykatat vendase u mbështetën kryesisht në rrezikun që aplikanti të mund të manipulonte provat dhe të bashkëpunonte me dëshmitarët, si dhe në rrezikun e arratisjes.

23. Gjykatat vendase iu referuan nevojës për marrjen e provave shtesë si bazë për ndalimin e zgjatur të aplikantit, pa bërë asnjë përpjekje të mëtijshme për të treguar se si kjo zbatohet konkretisht në rastin e aplikantit dhe zhvillimet e tij. Ato nuk arritën të specifikonin provat konkrete që duhej të mbledheshin, si dhe të shpjegonin pse këto prova nuk mund të ishin mbledhur në një fazë më të hershme të hetimit. Ata nuk iu përgjigjën pretendimit të aplikantit se dyshimi kundër tij bazohet ekskluzivisht në dokumente që ishin sekuestruar tashmë nga prokuroria dhe se, për këtë arsye, nuk kishte rrezik që ai të manipulonte ndonjë dëshmitar ose provë tjetër (shih paragrafin 4 më sipër).

Gjykatat vendase iu referuan vetëm, në terma të përgjithshëm, rrezikut që, nëse lirohet, aplikanti mund të manipulonte provat dhe të frikësonte dëshmitarët (krahaso Trzaska kundër Polonisë, nr. 25792/94, § 65, 11 korrik 2000; Hristov kundër Bullgarisë, nr. 35436/97, § 105, 31 korrik 2003; Belchev kundër Bullgarisë, nr. 39270/98, § 79, 8 prill 2004; dhe Eldar Hasanov kundër Azerbajxhanit, nr. 12058/21, § 135, 10 tetor 2024). Pohimi i Qeverisë se aplikanti ishte i njohur me personat nga të cilët do të merreshin deklaratat, në mungesë të ndonjë prove faktike konkrete mbështetëse ose ndonjë treguesi të përpjekjeve aktuale nga aplikanti për t'u angazhuar në manipulimin e provave, nuk mund të pranohet.

24. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Gjykata vëren se argumentet e aplikantit se ai kishte qenë jashtë vendit dhe ishte kthyer vullnetarisht në Shqipëri në muajt paraprakë, dhe se ai ishte dorëzuar vullnetarisht te autoritetet, pasi ishte informuar për urdhrin e ndalimit kundër tij, nuk janë peshuar siç duhet, edhe në dritën e faktorëve që lidhen me karakterin e personit, moralin e tij, shtëpinë, profesionin, pasuritë, lidhjet familjare dhe lidhjet e tjera me Shqipërinë (krahaso Buzadji, cituar më sipër, §§ 90 dhe 118). Gjykata vëren më tej se arsyetimi i gjykatave vendase nuk evoluoi për të reflektuar situatën në zhvillim dhe për të verifikuar nëse këto baza mbetën të mjaftueshme në fazën e avancuar të procedurave.

25. As nuk duket se ndonjë masë alternative sigurie është marrë në konsideratë siç duhet nga ato gjykata përtej një deklarate të thjeshtë formale, dhe pavarësisht kërkesave të shumta të aplikantit për këtë qëllim.”

Në vështrim të këtyre parimeve, për shkeljen e të cilave Shqipëria është dënuar ndërkaq në mënyrë të përsëritur në Strasburg²⁵, vlen të shtrohen dhe kujtohen para jush, të nderuar Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese pyetjet:

- Cili ishte rreziku që Z. Metaj të largohej ose t'i shmangej hetimit, dhe përse nuk e kishte bërë këtë deri në momentin e arrestimit, pavarësisht mundësive të pakufizuara?
- Cilat prova konkrete Z. Metaj rrezikonte të dëmtonte ose cilin dëshmitar rrezikonte të kërcënonte?
- Pasur parasysh se faktet në themel të hetimit penal dhe të masës kanë ndodhur shumë vjet më parë, përse pikërisht në tetor 2024 lindi dyshimi që këto prova mund të dëmtoheshin dhe përse nuk ishin dëmtuar më parë?
- Përse më parë, sidomos pasur parasysh që Z. Metaj ka ushtruar funksione shumë të rëndësishme në aparatit shtetëror, rreziku i manipulimit të provave dhe kërcënimit të dëshmitarëve nuk ka qënë i tillë sa të justifikonte masë arresti ndaj Z. Metaj, por ky rrezik lindi kur Z. Metaj nuk kishte më asnjë detyrë shtetërore por ishte vetëm Kryetar i Partisë së Lirisë, partia e dytë opozitare, në zgjedhjet parlamentare të 11 Majit që po afronin?
- Përse vetëm Z. Metaj dhe asnjë nga të dyshuarit e tjerë në këtë hetim penal kanë mundësi të dëmtojnë provat, pasur parasysh se ndaj tyre janë zbatuar masa më të lehta sigurimi ose asnjë masë, siç ka qënë rasti edhe ndaj Z. Metaj deri në 21 tetor 2024?
- Që nga data e arrestit të Z. Metaj a janë mbledhur provat që rrezikonin të dëmtoheshin dhe a vazhdon arresti i tij të jetë i arsyeshëm dhe proporcional edhe pas më shumë se 8-muajsh?

²⁵ Përveç vendimit Gëllçi të lartpërmendur shih gjithashtu *Delijorgji k. Shqipërisë*, no. [6858/11](#), §§ 39-50, 28.4.2015, and *Hysa k. Shqipërisë*, no. [52048/16](#), §§ 26-41, 21.2.2023.

- Në vështrim të këtyre rrethanave, përse një masë tjetër më e butë, si për shembull garanci, detyrim paraqitje ose arrest në shtëpi nuk ishte e përshtatshme në rastin e Z. Metaj?

Asnjë nga këto pyetje nuk është shtruar aspak në asnjë fazë të procedimit nga gjykatat më të ulëta.

Kjo është në shkelje flagrante të standardeve të kërkuara nga GJEDNJ, edhe në raste kur ka dënuar Shqipërinë për shkelje të nenit 5 KEDNJ, që i përmendëm më sipër.

Në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, kushtet, kriteret dhe procedurat e kufizimit të saj për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP.

Kështu, referuar kushteve të përcaktuara në nenin 228 të këtij Kodi, askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova (*pika 1*) dhe ato vendosen:

- i) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- ii) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;
- iii) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (*pika 3*).

Për sa u përket kriterëve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e tyre gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (*pika 1*) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete.

Në këtë rast, mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga KP (*pika 2*). Për sa u përket kriterëve të veçanta për caktimin e masës “Arrest në burg”, sipas nenit 230 të KPP-së, ajo mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit.

Gjykata Kushtetuese për të vlerësuar nëse masa e sigurimit “Arrest në burg” plotëson kriterin e proporcionalitetit duhet të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në lidhje me ekzistencën e *dyshimit të arsyeshëm të bazuar*

në prova, si dhe të njërit prej këtyre shkaqeve: ekzistencës së shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës ose kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; ose kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të tjera.

Gjithashtu, për të arritur në përfundimin se kjo masë plotëson kriterin e proporcionalitetit, Gjykata shqyrton nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshtëm kanë arsyetuar për vendosjen e masës së sigurimit, duke mbajtur në konsideratë *kontekstin e përgjithshëm të fakteve të çështjes*, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi, si dhe se *nëse ajo është në përpjestim me shkakat ligjor për të cilin është vendosur*, pra që çdo masë tjetër është e papërshtatshme.

Në këtë kuptim vlerësimi nëse ka pasur ose jo cenim së lirisë personale merret bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj kërkuesit.

Në rastin e kërkuesit nuk ka asnjë analizë në lidhje me plotësimin e kriterëve dhe kushteve të mësipërme duke mos u arsyetuar mjaftueshëm për arsyet të cilat kanë justifikuar kufizimin e lirisë së tij. Edhe pse gjykatat në dukje kanë analizuar dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova, se kërkuesi mund të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet referuar përmbajtjes së tyre rezulton në mënyrë të qartë se në rastin e kërkuesit ka pasur vetëm disa kallëzime dhe aludime e dyshime për kryerjen e disa veprave penale, ndërkohë që nuk ka asnjë provë konkrete që të jetë në atë nivel që të mbështesë dyshimin e arsyeshëm.

Nga ana tjetër, gjykatat nuk kanë analizuar rrezikun që paraqet kërkuesi për t'iu shmangur hetimit dhe për të kryer vepra të tjera më të rënda ose të të njëjtit lloj; cila është sjellja e mëparshme e tij e lidhur me personalitetin apo se ai i është shmangur më parë dënimit me burgim dhe se ekziston mundësia e rrezikut që ai të largohet përsëri; ekzistenca e rrezikut të marrjes, të prishjes ose të vërtetësisë së provave.

Në rastin konkret gjykatat kanë vendosur mbi të njëjtat fakte dhe dyshime për kryerjen e veprave penale masa të ndryshme ndaj personave të dyshuar, edhe pse ata janë në të njëjtat kushtet, kanë mbajtur funksione të ngjashme më të kërkuesit dhe dyshohen të kenë kryer të njëjtat vepra.

Gjykatat e konsiderojnë kërkuesin recidivist në mënyrë arbitrare duke paragjykuar qëndrimin e tyre dhe duke treguar njëanshmëri ekstreme në vlerësimin e rastit të tij.

Gjykatat nuk hetojnë rrezikun e ikjes në situatën që kërkuesi është lideri i një prej partive më të rëndësishme opozitare dhe se vendi po bëhej gati për fushatën

parazgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 ku opozita kishte një rol shumë të rëndësishëm dhe nevojitej të përgatitej.

Gjykatat u referohen disa procedimeve penale të nisura më herët në kohë dhe në kuadër të të cilave janë kryer veprime hetimore. Në kohën e arrestimit të kërkuesit dhe në vijim nuk ka asnjë element në arsyetimin e tyre se çfarë hetimesh synohet të kryhen dhe se si kërkuesi mund të prishë apo helmojë provat sa kohë ai për më tepër nuk ka asnjë funksion shtetëror dhe koha e kryerjes së këtyre veprave që pretendon akuza është shumë e largët.

Gjykatat nuk arsyetojnë se ku bazojnë rrezikun e ikjes apo kryerjes së veprave të tjera penale. Nëse do kishte dyshim për ikjen e kërkuesit apo shmangien drejtësisë do ishte e mjaftueshme heqja e pasaportës.

Në çështjen HYSA kundër SHQIPËRISË (*kërkesa nr. 52048/16*), datë 21 shkurt 2023 GJEDNJ ka vlerësuar se teksta paragrafi 1 (c) i nenit 5 parashikon arsyet mbi të cilat paraburgimi mund të jetë i lejueshëm; paragrafi 3, parashikon garanci të caktuara procedurale, duke përfshirë rregullin se gjykimi pezull për burgimin nuk duhet të tejkalojë afatin e arsyeshëm, duke rregulluar në këtë mënyrë kohëzgjatjen e tij.

Vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sinë qua non* për vlefshmërinë e paraburgimit, por pasi ka kaluar një kohë e caktuar – **që do të thotë që prej vendimit të parë gjyqësor që urdhëron arrestin me burg ai nuk është më i mjaftueshëm.**

Atëherë, Gjykata duhet të vendosë:

1. Nëse arsye të tjera cituar nga autoritetet gjyqësore vijnë të justifikojnë privimin e lirisë; dhe 2. Në rastet kur këto arsye ishin “të duhurat” dhe “të mjaftueshme”, nëse autoritetet vendase kanë shfaqur “kujdes të veçantë” në realizimin e procesit.

Justifikimi për çfarëdo periudhe burgimi, pavarësisht se sa e shkurtër ka qenë kjo periudhë burgimi, duhet të demonstrohet në mënyrë bindëse nga autoritetet (shih, midis shumë autoritetesh të tjerë. Justifikimet që janë vlerësuar arsye “të duhura” dhe “të mjaftueshme” – përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm – në praktikën gjyqësore të Gjykatës kanë përfshirë arsye të tilla si rreziku për t’u arratisur, rreziku i presionit ndaj dëshmitarëve ose rreziku i ndërhyrjes në prova, rreziku për marrëveshje të fshehta, rreziku për të kryer përsëri vepra penale, rreziku për të prishur rendin publik dhe nevoja për të mbrojtur personin e burgosur.

Sipas GJEDNJ deri në dhënien e dënimit, një i pandehur duhet të konsiderohet i pafajshëm dhe qëllimi i përcaktimit konkret, kryesisht, është të kërkojë lirimin e tij ose të saj paraprak menjëherë pasi burgimi i tij ose saj nuk është më i arsyeshëm.

Sipas GJEDNJ çështja nëse një periudhë e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Aspekti nëse është e arsyeshme që një i pandehur të qëndrojë në burg duhet të vlerësohet mbi faktet e secilës çështje dhe sipas tipareve të saj specifike. Vijimësia e burgimit mund të justifikohet në një çështje të caktuar vetëm nëse ka tregues specifik për një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale parashikuar në nenin 5 të Konventës.

Në radhë të parë u takon autoriteteve gjyqësore vendase të garantojnë, se në çdo çështje, paraburgimi i një të pandehuri nuk tejkalon afatin e arsyeshëm. Sipas rastit, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, ata duhet të shqyrtojnë të gjitha faktet pro ose kundër ekzistencës së kërkesës përmendur më sipër të interesit publik ose që justifikojnë shmangien e nenit 5 të KEDNJ, dhe më pas duhet t'i përfshijnë ato në vendimet e tyre për kërkesat për lirim. Gjykata duhet të garantojnë se argumentet në favor të dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”, por përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethana personale duke justifikuar paraburgimin e një kërkuesi

Në kuptim të kësaj jurisprudence gjykatat e zakonshme nuk kanë dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimet e tyre, në lidhje me paraburgimin e kërkuesit ndërkohë që Gjykata e Lartë i ka referuar formalisht në vendim shkaqet e rekursit pa bërë analizë të tyre në lidhje me bazueshmërinë në themel, duke mos i dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkuesit.

Masa e caktuar nuk ka qenë e *përshtatshme* dhe gjykatat nuk kanë plotësuar detyrimin që të arsyetojnë papërshtatshmërinë e masave të tjera dhe as nuk kanë arsyetuar për ekuilibrin që duhet të ekzistojë midis të drejtave kushtetuese të kërkuesit dhe interesit për mbarëvajtjen e procedimit penal ndaj tij dhe se përse masat e tjera të sigurimit nuk mund të përmbushnin qëllimin legjitim.

Masa nuk është as *e nevojshme* pasi kërkuesi nuk është e argumentuar dhe e arsyetuar se paraqet rrezik të largohet apo se mund të helmojë/dëmtojë provat. Mbajtja e tij i burgosur nuk i përgjigjet më situatës faktike dhe as nevojave që u justifikuan fillimisht në caktimin e saj.

Arsyetimi i gjykatave për të justifikuar paraburgimin e tij janë të vesuara sepse ato nuk kanë marrë parasysh personalitetin e personit nën hetim, i cili ka ushtruar funksione të rëndësishme kushtetuese si ish-Kryeministër, ish-Kryetar Kuvendi, ish-President i Republikës së Shqipërisë, disa herë ministër dhe së fundmi President i Partisë së Lirisë,

partisë së dytë opozitare më të madhe dhe partisë së tretë politike në Shqipëri në 20 vitet e fundit.

Kërkuesi nuk është përpjekur kurrë të ikte ose të pengonte drejtësinë (madje ai u ndalua duke hyrë në Shqipëri dhe jo duke dalë) dhe as nuk është përpjekur të rrezikonte ndonjë nga interesat në lidhje me paraburgimin

PËR CENIMIN E LIRISË SË SHPREHJES

GJEDNJ është shprehur se liria e shprehjes dhe e drejta për të kritikuar autoritetet nga ana e përfaqësuesve të opozitës është shumë më e gjerë sesa e individëve të thjeshtë²⁶.

Është e pamohueshme që Z. Metaj ka qënë një kritik i spikatur i Qeverisë dhe partisë në pushtet. Vetëm muajt e fundit përpara arrestit ai ka kritikuar dhe denoncuar me prova dhe fakte korrupsionin qeveritar, aferën me inceneratorët e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit, lidhjet e afërta të Kryeministrit Edi Rama me mafian ndërkombëtare, Sinaloa dhe Ndrangheta, që pastrojnë paratë në Shqipëri në sektorin e ndërtimit ku dyshohet se përfitojnë leje nga ai si Kryetar i Këshillit të Rregullimit të Territorit, gjithashtu edhe nën kamuflimin e investitorit strategjik.

Vetëm muajt e fundit, dhe konkretisht:

Më 16 shtator 2024, një muaj përpara arrestit ai ka kritikuar ashpër vendimin e mazhorancës socialiste në Kuvend, për të hedhur poshtë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për çështjen e mandatit të deputetes Olta Xhaçka duke e kritikuar publikisht Kryeministrin për shkelje flagrante të Kushtetutës dhe trajtimin prej tij të Kushtetutës si letër pa vlerë.

(Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=slu7tLqwT0M>)

Më 5 prill 2024, Z. Meta ka kundërshtuar dhe dënuar ashpër deklaratat e drejtuesit të SPAK, Z. Dumani se gjykatat vendosin afërmendsh atë që kërkon SPAK.

(Shih: <https://www.facebook.com/share/p/1DsYobJx9P/>)

²⁶ Shih Yalçiner k. Turqisë, no. 64116/00, §§ 38-49, 21/02/2008.

Gjithashtu, më 16 korrik 2024, ai ka kritikuar SPAK që nuk heton “provat ulëritëse të korrupsionit dhe inkriminimit të Kryeministrit Rama dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë”. (Shih: <https://www.facebook.com/reel/1131979374577211>)

Po kështu, më 27 maj 2024, Z. Metaj ka dënuar publikisht miratimin e së ashtëquajturës “Rezoluta anti-korrupsion”, nga shumica në Kuvend, si “poshtërim të reformës në drejtësi”, duke e akuzuar Kryeministrin Rama për “vendosje nën kontroll absolut të institucioneve të drejtësisë”.

(Shih: <https://www.facebook.com/photo?fbid=1000483798113522&set=a.402543174574257>)

Po kështu, më 7 mars 2024, ai ka akuzuar Kryeministrin se nëpërmjet ligjit “Për investimet strategjike”, synon grabitjen e pronave shtetërore dhe atyre të ligjshme private të qytetarëve. (Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=jLR7FM1R9Fg>)

E gjithë kritika dhe aksioni i tij politik po merrnin përmasa në rritje, në vështirësi edhe të fushatës elektorale, që po afrohej.

Arrestimi i Z. Metaj, përveçse i pajustificuar për qëllimet e nenit 5 KEDNJ, i kufizon atij në maksimum edhe lirinë e shprehjes si përfaqësues politik i opozitës, në shkelje të nenit 10 të KEDNJ. Kjo masë jo vetëm që është jo legjitime, por është haptazi jo-proporcionale.

Qëllimi për të mohuar lirinë e shprehjes së Z. Metaj me anë të arrestit u konkretizua më datë 10 qershor 2025, kur pas një interviste me gazetaren Znj. Beti Njuma, Z. Metaj iu ndalua e drejta për aktivitet sportiv; në datën 27 qershor 2025, një ditë pasi lajmëroi konferencë shtypi nga kabina telefonike, i kufizua tërësisht mundësia e komunikimit me çdokënd, si edhe në datën 2 korrik 2025, pasi një interviste me gazetaren Znj. Aida Tancica, iu kufizua e drejta për komunikim me drejtuesit e Partisë së Lirisë, në shkelje të nenit 10 KEDNJ.

Komisioni Disiplinës pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, “Jordan Misja”, nisur nga një telefonatë e ligjshme që kërkuesi Z. Ilir Metaj ka patur më 2 korrik 2025 me avokatin e tij Z. Kujtim Cakrani, ndërkohë që ky i fundit ishte live në televizionin MCN dhe pasi ai e hapi telefonin live gazetaria gjeti rastin për t’i bërë disa pyetje ish-Presidentit Ilir Metaj, i cili ju përgjigj në mënyrë korrekte pa asnjë nuancë shpifje apo fyerje dhe shantazhi për askënd, në shkelje të ligjit dhe të rregullores së IEVP dënoi Z. Metaj me masë disiplinore ndërkohë nuk ka asnjë dispozitë të ndalojë komunikimet e tij me avokatin dhe nëpërmjet tij me mediat.

Ky veprim ndëshkues i Komisionit të Disiplinës është në vazhden e represionit, diskriminimit dhe dhunës psikologjike që përdorin institucionet në varësi nga Qeveria dhe posaçërisht nga Kryeministri.

I njëjti dënim, ka ndodhur edhe me rastin tjetër, kur ish-Presidenti Z. Ilir Metaj pas thirrjes telefonike me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Lirisë, Z. Tedi Blushi, kur ky i fundit ndodhej në një studio televizive dhe rastësia bëri që ish-Presidenti të komunikonte me moderatoren e emisionit Znj. Beti Njuma, atij t'i ndalohej për 10 ditë e drejta për ushtruar aktivitete të përbashkëta sportive, ndalim që vazhdon edhe aktualisht.

Gjithashtu, Z. Metaj i është mohuar në mënyrë të përsëritur e drejta edhe të komunikonte me mediat, ditën e votimit më 11 Maj, si edhe për t'u takuar dhe vizituar nga drejtuesit dhe deputetët e Partisë së Lirisë, deputetë të tjerë, gazetarë, si edhe me eurodeputetë. Po kështu, për dy javë iu mohuan edhe takimet me familjarët.

(Shih: <https://www.facebook.com/share/p/1LX7agYJrw/>)

(Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=CLhxx2WDAOo>)

Padyshim që këto veprime të Komisionit të Disiplinës pranë IEPV “Jordan Misja” kanë një regji politike sepse është e pamundur që të sillesh në mënyrë kaq brutale duke i kufizuar ish-Presidentit të Republikës dhe Presidentit të forcës së dytë opozitare në vend edhe lirinë e shprehjes.

Liria e shprehjes edhe pse mund të jesh në kushtet e izolimit me vendim gjykatë nuk mund t'i hiqet askujt, kjo është e sanksionuar jo vetëm në Kushtetutën e Shqipërisë por edhe në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Mosndërrhyrja apo indiferenca e autoriteteve për këtë situatë vërteton se kjo sjellje është e koordinuar po nga vet autoritetet e larta të vendit si Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë si personi që ka nën varësi institucionet e paraburgimit.

Për këtë sjellje krejt të paprecedentë ndaj ish-Presidentit të Republikës nuk kanë ndërhyrë as Avokati i Popullit, si institucioni që duhet të shqetësohet më shumë se kushdo tjetër për sjelljet diskriminuese që prekin liritë dhe të drejtat e njeriut sidomos liritë dhe të drejtat e të paraburgosurve.

Kjo ndërhyrje përbën shkelje të nenit 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, dhe në frymën e kësaj në fakt duhet të shqetësohej edhe Komiteti i Helsinkit, sepse në një vend që mendohet se është demokrtatik është shkelur e drejta e fjalës.

C. PËR CENIMIN E SË DREJTËS PËR T'U ZGJEDHUR

Si pasojë e vendosjes së masës “Arrest në burg” kërkuesi është vënë në pamundësi që të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit 2025 duke bërë fushatë në krye të partisë së tij dhe të udhëheqë opozitën, që ai përfaqëson jo vetëm për të marrë vota si kandidat i veçantë ashtu edhe për partinë e tij.

E drejta për t'u zgjedhur garantohet nga neni 45 i Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit (**Shih** vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese).

I gjithë ky proces, nisur nga kallëzimi ndaj kërkuesit dhe duke vijuar me ndalimin e tij përpara fushatës zgjedhore janë një skenar i paracaktuar që ka nisur me sulmet ndaj tij që kur kryente funksionin e Presidentit të Republikës, që kulmuan me kërkesën e shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese ku ajo evidentoi edhe sjelljet e individëve përfaqësues të shumicës dhe qëllimet e tyre denigruese ndaj kërkuesit dhe forcës politike që ai përfaqëson.

Sjellja e prokurorisë dhe gjykatave në kushtet kur mungon arsyetimi për nevojën dhe përshtatshmërinë e masës së arrestit ka haptazi një qëllim politik, ai për të ndalur kërkuesin të bënte fushatë dhe të drejtonte forcën e tij politike gjatë fushatës zgjedhore.

Ato kanë qenë në favor të partisë në pushtet me synimin për të mënjeluar një nga udhëheqësit kryesorë të opozitës. Çështja e tij dukshëm është e sajuar dhe qëllimi i vetëm është kufizimi i një udhëheqësi politik të opozitës në aktivitetet e fushatës zgjedhore duke qenë kjo pjesë e një axhende të mirëpërcaktuar politike.

Këtë e provon edhe fakti se edhe pse gazetarët ishin lajmëruar ditën e zgjedhjeve nga IEPV “Jordan Misja” të filmonin momentin e votimit të Z. Metaj, qëllimisht ata u penguan ta filmonin.

(**Shih:** <https://web.facebook.com/watch/?v=10073126912739364>)

(**Shih:**<https://a2news.com/shqiperia/politike/u-tremben-se-doli-i-veshur-kuqezi-blushi-demonstrat-i-1147686>)

Ftojme Gjykatën Kushtetuese të bëjë në themel vlerësimin e kësaj shkelje, duke bërë krahasimin dhe dallimin me vendimin e GJEDNJ në çështjen Uspaskich k. Lituani²⁷.

(Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=q-xv6sZS4s4>)

Nenet 25, 30 dhe 42 të Kushtetutës parashikojnë: *Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë; Liria dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.*

Neni 27 i Kushtetutës së Shqipërisë thotë se:

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme:
 - a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
 - b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
 - c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

Parimisht, masat e sigurimit personal vendosen:

a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme, që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti, që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;

b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet (neni 228/3 i KPP); Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre, me shkallën e nevojave të sigurimit, që duhen marrë në rastin konkret (Shih nenin 229/1 i Kodit të Procedurës Penale). Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban, me pasojë pavlefshmërie...

c) parashtrimin e shkaqeve të posaçme dhe të të dhënave, që përligjin masën e sigurimit;

²⁷ No. 14737/08, 20/12/2016.

ç) parashtrimin e shkaqeve, pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimi i papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit, kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të këtij Kodi (shih nenin 245/1 i Kodit të Procedurës Penale); I pandehuri prezumohet i pafajshëm, gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë... (shih nenin 4 i Kodit të Procedurës Penale).

Në çështjen Navalny etj. kundër Rusisë, GJEDNJ u shpreh: “...se Gjykatat vendase nuk kishin bërë asnjë përpjekje, për të verifikuar masën e rrezikut, që përbënin aplikuesit, nëse ishte e nevojshme, për t’i ndaluar ata; Edhe nëse prezumohet, që aplikuesit nuk i ishin bindur urdhrit për ndalim, nuk kishte arsye për t’i arrestuar ata. Masat shtrënguese të marra kishin një potencial serioz, për të penguar mbështetësit opozitarë, në marrjen pjesë, në përgjithësi, në debatin e hapur politik. Efekti pengues i këtyre sanksioneve ishte fuqizuar më tej, nga fakti që ato kishin, si objektiv figura të njohura publike, heqja e lirisë së të cilëve, kishte tërhequr vëmendje të gjerë të mediave. Kështu, ndërhyrja nuk ishte e nevojshme, në një shoqëri demokratike. Ka shkelje të nenit 5 të KEDNJ, edhe në lidhje me shoqërimin e panevojshëm, në rajonin e policisë dhe mungesën e shkaqeve, për ndalimin e tyre;

Në çështjen Gutsanov kundër Bullgarisë, GJEDNJ u shpreh “...se gjatë operacionit policor, përmbante forcë fizike dhe Z. Gutsanov u neutralizua, nga punonjës të armatosur, që kishin vënë maska, ishte ulur me forcë dhe i ishin vënë prangat. Z. Gutsanov ishte Kryetari i Këshillit Bashkiak të Varnas dhe ishte figurë e mirënjohur politike në qytet. Nuk kishte prova, që do të nënkuptonin, që ai kishte të shkuar të dhunshme dhe mund të përbënte një rrezik, për punonjësit e policisë. Edhe prania e një arme, në banesën e kërkuësve, nuk mund të justifikonte angazhimin e njësisë së ndërhyrjes së shpejtë ose llojin e forcës, që u përdor. Operacioni policor ishte planifikuar dhe zbatuar, pa marrë parasysh, edhe faktin, që ai nuk kishte të shkuar të dhunshme; Të gjithë këta elementë tregonin qartazi, që mjetet e përdorura, për të arrestuar, ishin të tepruara; për pasojë, ai gjithashtu i ishte nënshtruar trajnimit poshtërues.

Z. Gutsanov kishte qenë i dyshuar në një çështje në lidhje me përfitimin e fondeve publike dhe abuzimin me detyrën, por ai nuk ishte dyshuar, për përfshirje në aktivitete të dhunshme kriminale. Gjykatat e Bullgarisë urdhëruan ndalimin e tij, në vazhdimësi, për shkak se ai mund të kryente vepra të tjera penale, veçanërisht duke manipuluar provat. Gjykata e Apelit, në vendimin e datës ..., pati mendimin që “rreziku i fundit nuk vazhdonte të ekzistonte, duke pasur parasysh dorëheqjen e kërkuësit, nga pozicioni i mëparshëm si Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Z. Gutsanov, megjithatë, u vendos në arrest shtëpie, ndërsa Gjykata e Apelit nuk dha ndonjë shkak specifik, që të justifikonte masën, që kishte mbetur në fuqi, për dy muaj. Për pasojë, GJEDNJ nxori përfundimin, që autoritetet, nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre, për të justifikuar ndalimin, në vazhdimësi të kërkuarit, pas datës;

Komentet e bëra nga Ministri i Brendshëm një ditë pas arrestimit të Z. Gutsanov (dhe që ishin publikuar në një gazetë në momentin kur çështja ishte objekt i interesit të fortë publik), kishin shkuar tej dhënies së informacionit. Sipas GJEDNJ, komentet e Ministrisë dukeshin sikur i jepnin publikut përshtypjen, që Z. Gutsanov ishte një nga “drejtuesit”, pas grupit kriminal që kishte përvetësuar shuma të mëdha nga paratë publike. GJEDNJ nxori përfundimin që komentet kishin shkelur të drejtën e Z. Gutsanov, për t’u prezumuar i pafajshëm. Në lidhje me shkakun, për vendimin, që urdhëronte ndalimin, në vazhdimësi të Z. Gutsanov, gjyqtari kishte deklaruar që “...gjykata mbetet e mendimit që ishte kryer një vepër penale dhe që i akuzuari ishte i përfshirë...”. Sipas GJEDNJ, kjo frazë është e barabartë, me deklarimin e fajit, para se të merrej ndonjë vendim, për themelin dhe kishte shkelur të drejtën e Z. Gutsanov, për t’u prezumuar pa faj.

Çështja Gëllçi kundër Shqipërisë (2025): GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 5/1 të KEDNJ për shkak të mungesës së bazës ligjore dhe provave konkrete, për të justifikuar paraburgimin. GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 5/3 të KEDNJ, për shkak të kohëzgjatjes joproporcionale të paraburgimit, duke arsyetuar si vijon: “se akuzat e prokurorisë ishin të përgjithshme dhe të pambështetura nga prova konkrete...; se shpërdorimi i supozuar i detyrës, nuk përbënte një kërcënim të rëndë dhe të pashmangshëm, që justifikonte kufizimin e lirisë; se autoritetet mund të kishin përdorur masa më pak kufizuese, si konfiskimi i dokumenteve ose pezullimi nga detyra. Zgjatja e paraburgimit, nuk ka arsyetim të mjaftueshëm, duke e konsideruar atë joproporcional. Se mungesa e provave dhe publiciteti i bujshëm i arrestimit, minojnë besimin në sistemin e drejtësisë.

...se shprehjet “i ligjshëm” dhe “në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj”, në nenin 5/1 të KEDNJ, deklarojnë nevojën për përputhshmëri, me procedurën përkatëse sipas këtij ligji. Nocioni bazë i termave, në fjalë, lidhet me procedurën e drejtë dhe të rregullt, përkatësisht, që çdo masë, që i mohon një personi lirinë, duhet të jepet dhe të ekzekutohet, nga një organ i duhur dhe nuk duhet të jetë arbitrare (Shih vendimet e GJEDNJ, për çështjet vijuese: Winterwerp k. Holandës, vendimi dt. 24 tetor 1979, 45; Wassink k. Holandës, vendimi dt. 27 shtator 1990, 24 dhe Bik k. Ruisë, aplikimi Nr. 26321/03, 30, vendimi dt. 22 prill 2010).

Në analizë logjike të jurisprudencës kushtetuese dhe këtyre vendimeve të GJEDNJ, nxirren konkluzionet dhe shkeljet konkrete:

Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi një masë arresti, vetëm me dyshime dhe personi është nën hetim pa i komunikuar asnjë akuzë, ndërkohë që në Kushtetutën e Shqipërisë thuhet se: Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në kuptim të kësaj dispozite masa e arrestit kërkuar nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit Organizuar (SPAK) dhe vendosur nga gjykatat bie ndesh me parimet bazë kushtetuese të heqjes së lirisë.

Vendimet e gjykatave nuk janë të arsyetuara qartë në raport me **rrezikshmërinë individuale**, por bazohen në formulime të përgjithshme madje në arsyetimin e saj Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji ka shkuar edhe më tej duke paragjykuar (parimi i gjykatës së paanshme) personin nën hetim, ish-Presidentin e Republikës, Z. Ilir Metaj si **recidivist** për të njëjtat vepra penale.

Padyshim që ky fragment në arsyetim të vendimit gjykatës nuk mund të jetë një lapsus por është një veprim i qartë për të justifikuar paligjshmërinë e vendimeve që kanë lënë në fuqi masën e “Arrest me burg”.

Kujtojmë këtu se fraza “është recidivist, ose përsëritës” i një veprë shoqërisht të rrezikshme nga një njeri, që është dënuar më parë me gjyq, nuk ka asnjë bazë sepse personi nën hetim, ish-Presidenti i Republikës, Z. Ilir Metaj nuk ka qënë më parë i dënuar për ndonjë veprë penale dhe në këtë kuptim nuk ka se si të jetë recidivist (përsëritës).

Shkelja e Nenit 28 të Kushtetutës dhe Nenit 5(2) të KEDNJ

Këto nene garantojnë të drejtën e çdo personi të informohet, për **arsyet e arrestimit** dhe **natyrën e akuzës** kundër tij.

Nuk është bërë një përshkrim i saktë i veprave penale.

Nuk është përcaktuar **natyra e saktë** e veprimit penal që i atribuohet të arrestuarit.

Dosja paraqitet me terma të paqartë, të tilla si “dyshohet se ka bashkëpunuar me persona të tjerë në aktivitet kriminal”, por që mungojnë veprimet konkrete që lidhen me aktin kriminal, çka nënkupton se veprat penale janë të paqartësuara dhe tërësisht mbi baza dyshimesh dhe hamendësimesh.

Në rastin konkret është shkelur “Parimi i proporcionalitetit” (Kushtetuta (Neni 17), Kodi i Procedurës Penale dhe KEDNJ)

Masa e sigurimit “**Arrest në burg**” është **masa më e rëndë** dhe duhet të përdoret vetëm kur masat më të lehta nuk janë të mjaftueshme.

Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar mjaftueshëm, sipas parimeve kushtetuese (neni 142/1 i Kushtetutës), sipas parimeve konventore (neni 6 i KEDNJ) dhe sipas neneve 228, 229 dhe 245/1 të KPP, lidhur me arsyetimin, se pse **nuk mund të aplikohet një masë më e lehtë** (arrest shtëpie, detyrim paraqitjeje, bllokim pasaporte, etj.) masa që janë të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Se akuzat e prokurorisë janë të përgjithshme dhe të pambështetura, nga prova konkrete, duke mos përmbushur standardin e nevojës, për të parandaluar një rrezik të menjëhershëm financiar ose publik; se veprat penale, objekt akuze aktuale, nuk përbëjnë një kërcënim të rëndë dhe të pashmangshëm, që justifikonte kufizimin e lirisë të Z. Ilir Metaj; nuk ekzistojnë shkaqe të rëndësishme, që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave të administruara deri tani; nuk provohet mjaftueshëm largimi (para se të ndalohej nga policia) , nuk provohet as ekzistenca e rrezikut të largimit eventual (nuk janë arsyetuar mjaftueshëm, këto rrethana ligjore, prej gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor).

Vazhdimi i paraburgimit të ish-Presidentit të Republikës, Z. Ilir Metaj, deri tani, me arsyetim të pamjaftueshëm (prej gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor), është joproporcional dhe përbën shkelje të nenit 5/3 të KEDNJ.

Duke mbajtur parasysh, në mënyrë kumulative antagonizmin politik të raportuar gjerësisht në media, para burgimit, midis ish-Presidentit të Republikës Z. Ilir Metaj dhe Kryeministrit Edi Rama (**Shih:** <https://www.youtube.com/watch?v=q-xv6sZS4s4>) antagonizmin e raportuar gjerësisht në media, para burgimit, midis Z. Ilir Metaj dhe drejtuesit aktual të SPAK (i cili është edhe prokuror i çështjes të Z. Metaj që nga Dhjetor 2019), rrjedhja në media e akteve hetimore, objekt akuze dhe mangësitë e rënda (të evidentuara, në këtë ankim kushtetues), lidhur me procedurat gjyqësore të deritanishme, për paraburgimin e Z. Ilir Metaj (referuar nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 42/1 të Kushtetutës) provon indirekt dhe mjaftueshëm faktin se Prokuroria ka patur një axhendë të fshehur dhe ka qenë *mjaftueshëm* e ndikuar politikisht, nga shumica qeverisëse politike Partia Socialiste (e drejtuar prej Kryeministrit Edi Rama), për diskreditimin politik, personal e familjar të Z. Ilir Metaj.

Pra, fokusi mbizotërues, në çështjen hetimore dhe gjyqësore, ndaj Z. Ilir Metaj, nuk ka qenë parandalimi i korrupsionit në shërbimin publik apo hetimi objektiv i një vepre të pretenduar, por më shumë përbën një sulm personal ndaj integritetit politik e personal të Z. Metaj (**Shih** qasjen, sipas vendimit të GJEDNJ, për çështjen Artem Sytnyk kundër Ukrainës, aplikimi Nr. 16497/20, vendimi dt. 24. 04. 2025; **Shih** njoftimin e GJEDNJ për këtë çështje).

Se (referuar parimeve kushtetuese dhe rasteve të GJEDNJ) provohet, se policia gjyqësore apo Forca e Posaçme Operacionale, që ndaloi Z. Metaj, ishin të pidentifikuar dhe me maska, nuk i paraqitën asnjë shkresë zyrtare ndalimi, nuk e lejoi atë të njoftojë menjëherë avokatit e tij; nuk i ofroi atij (menjëherë/pa vonesa, në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të shpejtë) informacionin e nevojshëm, të mjaftueshëm, për arsyet/shkaqet specifike dhe thelbësore, për bazën ligjore e faktike të ndalimit të tij (për t'i garantuar/siguruar, që ai të ketë të drejtat e tij, të mbrojtura dhe që të kuptojë mjaftueshëm arsyet/shkaqet e ndalimit të tij), e rrëmbyen me dhunë dhe e futën në një makinë private.

(Shih: <https://youtu.be/GyRp1yR5LFs?si=eZ5KdV3NpxBlnl-a>)

Ka shkelje të nenit 5 të KEDNJ, në lidhje me shoqërimin e panevojshëm, nga Policia e Shtetit, të Z. Ilir Metaj, sepse nuk i kanë njoftuar atij vendimin gjyqësor, ku bazohej veprimi i tyre. Kjo vonesë (në ofrimin e këtij informacioni), përbën mjaftueshëm një shkelje të rëndësishme të të drejtave të tij, sipas nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 42 të Kushtetutës (që garantojnë të drejtën për një proces të drejtë).

Meqënëse gjatë ndalimit të tij, u përdor dhunë/forcë fizike e panevojshme, u përdor filmim dhe publikim (i kësaj sjellje dhune), në median elektronike, përbën shkelje të nenit 3 të KEDNJ (sepse janë kryer me qëllimin degradues të personalitetit dhe figurës të tij politike, publike dhe opozitare, por edhe për frikësimin e përkrahësve të Partisë së Z. Metaj dhe të opozitës).

Se (referuar parimeve kushtetuese dhe rasteve të GJEDNJ) provohet, se Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të verifikuar masën e rrezikut, që përbënte Z. Ilir Metaj (nëse ishte e nevojshme, për ta ndaluar atë).

Edhe nëse prezumohet, që Z. Ilir Metaj nuk i ishte bindur urdhrit për ndalim, përsëri nuk kishte arsye për ta arrestuar, sepse forca speciale me maska dhe të pidentifikuar nuk i ka paraqitur Z. Ilir Metaj, vendimin gjyqësor, ku bazohej veprimi i tyre. Masa e arrestimit (kur nuk ka rrezik largimi), kishte një potencial serioz, për të penguar atë, si lider opozite, në pjesëmarrjen e tij, në përgjithësi, në debatin e hapur politik e publik. Efekti pengues i kësaj mase sigurimi është fuqizuar më tej, nga fakti që kjo masë sigurimi kishte si objektiv Z. Ilir Metaj, si figurë e njohur publike e politike, heqja e lirisë së të cilit, kishte tërhequr vëmendje të gjerë të mediave.

Arrestimi i Z. Ilir Metaj ishte paralajmëruar prej kohësh në media nga burime të përdorura nga SPAK-u për një kohë të gjatë dhe ishin bërë publike në gazetatat dhe

mediat me qëllim largimin ose përgatitjen e opinionit për atë arrestim, që do të ndodhte dhe vet mënyrën se si u realizua.

(Shih: <https://youtu.be/GyRp1yR5LFS?si=eZ5KdV3NpxBlnl-a>).

Kështu, ndërhyrja e sistemit gjyqësor (me masë sigurimi paraburgim) nuk ishte e nevojshme, në një shoqëri demokratike. Gjatë operacionit policor, kishte forcë fizike dhe Z. Ilir Metaj u neutralizua, nga punonjës të armatosur, që kishin vënë maska, u zbrit me forcë nga mjeti motorrik dhe i janë vënë prangat dhe futur në makinë private.

Z. Ilir Metaj është President i Partisë së Lirisë, ish-President i Republikës, ish-Kryetar i Kuvendit, ish- Kryeministër, ish-Ministër dhe figurë e mirënjohur publike, në Shqipëri dhe jashtë saj, prej vitit 1992.

Nuk kishte prova, që do të nënkuptonin, se ai kishte të shkuar të dhunshme dhe mund të përbënte një rrezik eventual, për punonjësit e Policisë. Operacioni i dhunshëm ishte planifikuar dhe zbatuar, pa marrë parasysh edhe faktin, që ai nuk ishte i dënuar më parë dhe nuk ishte dyshuar, për përfshirje në aktivitete të dhunshme kriminale. Për më tepër që Z. Meta gëzonte edhe statusin ligjor si ish-President i Republikës dhe mbrojtjen nga Garda e Republikës, në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Pavarësisht përputhshmërisë me formulimin e neneve 25, 27, 28 të Kushtetutës, neneve 228, 238 të Kodit të Procedurës Penale provohet qartazi, se në rastin konkret ka ekzistuar elementi i keqbesimit nga SPAK, BKH dhe/ose Policia e Shtetit, për ekzekutimin e ndalimit/paraburgimit të Z. Ilir Metaj.

Kushti për mospasje arbitrariteti kërkon parimisht, që si urdhri “për ndalim/paraburgim” dhe ekzekutimi i ndalimit/paraburgimit, të jenë të dy, tërësisht, në përputhje me qëllimin e kufizimit të lejuar, prej nenit 5/1 të KEDNJ.

Po ashtu, duhet të ketë parimisht një marrëdhënie, ndërmjet shkakut, mbi të cilin është marrë vendimi për heqjen e lirisë dhe kushteve të ndalimit.

Për pasojë (referuar fakteve, rrethanave, shkaqeve dhe arsyeve të paraburgimit të Z. Ilir Metaj) të gjithë këta elementë tregojnë qartazi se mjetet e përdorura për të paraburgosur Z. Ilir Metaj, ishin qëllimisht të tepruara dhe ai i është nënshtruar trajtimit poshtërues e ndalimit tij arbitrar (Shih qasjen e vendimit të GJEDNJ, për çështjen Saadi kundër Mbretërisë së Madhe, aplikimi Nr. 13229/03 , § 68).

Po kështu, fakti që SPAK-u nuk hetoi kallëzimin e bërë në datën 6 dhjetor 2024 nga Partia e Lirisë ndaj Policëve që kryen rrëmbimin në mesin e rrugës më kryesore të

Tiranës, tregon mungesën e përgjegjësisë dhe bashkëfajësimin, gjithashtu dhe ndikimin politik të policisë, Drejtorit Përgjithshëm të Policisë Shtetit, i cili në shkresën “Kthim përgjigje për Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë së Lirisë, Z. Tedi Blushi”, thotë ndër të tjera se, policët kishin urdhërin e ekzekutimit të lëshuar nga prokuroria e posaçme në zbatim të vendimit penal Nr. 125, datë 20.10.2024 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, për arrestimin e ish-Presidentit, Z. Ilir Metaj.

Kjo “Kthim përgjigje” e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ilir Proda, ishte një mashtrim i pastër për të justifikuar brutalitetin dhe dhunën e përdorur sepse e vërteta qëndron krejtë ndryshe.

Policia e Shtetit në momentin e ndalimit apo rrëmbimit të ish-Presidentit Metaj së pari nuk kishte asnjë mjet identifikimi nga ato që parashikon ligji, që nënkupton nuk kishin asnjë ndryshim nga banditë me uniformë, së dyti, nuk kishin asnjë dokument urdhër ekzekutimi në momentin që ndaluan makinën ku udhëtonte ai.

Z. Metaj u njoh me urdhër-arrestin vetëm pas 3 orësh kur kishte shkuar në Drejtorinë e Policisë Tiranë dhe pasi i kishte mbërritur më parë, i njoftuar vetëm nga mediat, avokati Genc Gjokutaj.

Pra kjo vërteton edhe njëherë se ish-Presidenti Z. Ilir Metaj u rrëmbye, dhunua dhe poshtërua në mesin e një prej rrugëve kryesore të Tiranës me urdhër politik të partisë në pushtet (Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=q-xv6sZS4s4>) dhe fakti që nuk pati asnjë reagim apo hetim qoftë edhe administrativ për policët (banditë) vërteton se jemi përpara një situatë krejt të paprecedent për një shtet të së drejtës, që ndodh vetëm në vende diktatoriale apo regjime autokratike.

Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë urdhëruan arrestimin e tij, në vazhdimësi, pa përmbushur detyrimin e tyre për të justifikuar ndalimin (referuar shkaqeve specifike).

Interpretimi i kryer prej Gjykatës të Shkallës së Parë, prej Gjykatës së Apelit dhe prej Gjykatës së Lartë është mjaftueshëm interpretim arbitrar, i paarsyeshëm dhe nuk përputhet mjaftueshëm me interpretimet e GJEDNJ. Se Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, nuk i kanë dhënë përparësi mjaftueshëm (në çështjen e Z. Ilir Metaj) konkluzioneve, sipas këtyre vendimeve të GJEDNJ.

Komentet e bëra nga SPAK, pas arrestimit të Z. Ilir Metaj dhe që (këto komente) ishin publikuar në media (kur çështja ishte objekt i interesit të fortë publik), kishin shkuar mjaftueshëm, përtej dhënies së informacionit. Komentet e tyre duken, sikur i jepnin

publikut përshtypjen, që Z. Ilir Metaj ishte fajtor. Pra, këto komente kanë shkelur mjaftueshëm, edhe të drejtën e Z. Ilir Metaj, për t'u prezumuar i pafajshëm (referuar neneve 30 të Kushtetutës dhe nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale), para se të merret ndonjë vendim gjyqësor, për themelin e çështjes së tij.

Mënyra/forma, se si u veprua publikisht dhe me filmim, për ndalimin shumë të dhunshëm të Z. Ilir Metaj nuk ishte rreptësisht i nevojshëm dhe nuk u shkaktua, nga sjellja e Z. Ilir Metaj.

Mënyra e paligjshme dhe e dhunshme e ndalimit synonte të poshtëronte dhe të ulte dinjitetin e Z. Ilir Metaj, në sytë e familjes së tij dhe të publikut, duke iu nënshtuar mjaftueshëm, një trajtimi poshtëruar e denigrues, i cili bëhej në prag të zgjedhjeve politike të 11 Majit, si mesazh frikësues për përkrahësit e opozitës.

Pra, kemi shkelje të nenit 8 të KEDNJ (e drejta për respektimin e jetës së tij private dhe jetës së tij familjare), shkelje të nenit 25 të Kushtetutës dhe shkelje të nenit 3 të KEDNJ. Faktet e vërtetuara ishin të arsyeshme dhe të mbështetura mjaftueshëm, në prova. Meqenëse rrethanat e ndalimit të Z. Ilir Metaj lidhen me veprimet e SPAK, me veprimet e BKH dhe/ose Policisë së Shtetit (pra, këto veprime ndodhën plotësisht ose kryesisht, brenda njohurisë ekskluzive të organeve shtetërore) barra e provës, i takon SPAK, që parimisht duhet të ofrojë një shpjegim të pëlqyeshëm dhe bindës, për rrethanat/kushtet/kriteret ligjore, që janë patur parasysh, për ndalimin e dhunshëm të Z. Ilir Metaj (**Shih** qasjen, sipas vendimeve të GJEDNJ, për çështjet: Salman kundër Turqisë, aplikimi Nr. 21986/93, § 100 dhe Anguelova kundër Bullgarisë, aplikimi Nr. 38361/97, § 111).

Vendimi i Gjykatës së Lartë është bazuar në rrezik të supozuar për prishje provash, intimidim të dëshmitarëve dhe rrezik largimi, por që këto nuk janë të argumentuara mjaftueshëm konkretisht (Neni 27 (kufizimi i lirisë) në lidhje me parimin e proporcionalitetit (Neni 17 i Kushtetutës).

Shkelje të Nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)

Ky nen kërkon që masa e sigurimit personal të vendoset kur ekzistojnë **të dhëna konkrete** për një vepër penale dhe për rrezikun që paraqet i dyshuari.

Nuk paraqiten **prova materiale apo të dhëna specifike** për të justifikuar masën.

Vendimi bazohet vetëm në raportin e policisë apo një informacion inteligjence, pa verifikim gjyqësor.

Shkelja e së drejtës për një proces të rregullt ligjor (Neni 42 i Kushtetutës dhe Neni 6 i KEDNJ)

Gjykata duhet të garantojë se çdo vendim që kufizon një të drejtë themelore, si liria, të jetë rezultat i një procesi të drejtë dhe të paanshëm.

Mungesë e transparencës dhe arsytimit në vendim.

Janë refuzuar ose nuk janë marrë parasysh pretendimet e palës mbrojtëse të personit nën hetim për të paraqitur prova ose për të kundërshtuar provat e prokurorisë. (E drejta e mbrojtjes)

Vendimi i gjykatës është kopje e kërkesës së organit të procedurës, që nuk ka një analizë të pavarur që nënkupton, nuk janë marrë parasysh, fakti që: Nuk kemi të bëjmë me **flagrancë** apo **rrezik konkret ikjeje, ndikimi mbi prova apo dëshmitarë**, pra **masa e “Arrest në burg” është e pajustificuar** dhe jopropocionale, pasi “Arrest në burg” duhet të jetë **masa e fundit**, dhe vetëm nëse **asnjë masë tjetër** nuk mund të garantojë hetimin.

Gjykatat në vendimet e tyre, ashtu si organi i akuzës, janë bazuar në dyshime, por nuk ka prova konkrete për dyshimin e arsyeshëm sepse duhet të: (nuk kanë arsyetuar “te j çdo dyshimi të arsyeshëm”)

Tregojnë lidhjen **e drejtpërdrejtë** të personit me aktin e dyshuar të korrupsionit; Argumentojnë se ekziston **rrezik aktual dhe real**, jo vetëm dyshime të përgjithshme; Justifikojnë **pse është e nevojshme** ndalimi në këtë moment, për një vepër të ndodhur shumë vite më parë.

Gjithashtu nuk kanë vlerësuar drejt pozitën e të dyshuarit në shoqëri:

Personi nën hetim është person publik me rol institucional dhe histori politik;

Ka më **pak gjasa** për t’u arratisur;

Ka më **shumë mundësi për t’u mbrojtur në liri**;

Ka më **shumë rëndësi** për garantimin e një procesi të ndershëm dhe të balancuar (për të mos u perceptuar si proces politik);

Sa më e largët të jetë koha e kryerjes së veprës penale, aq më **i lartë është standardi i provave** që kërkohen për të justifikuar një masë të tillë.

Arrest arbitrar dhe pa bazë ligjore (Neni 5(1) i KEDNJ)

Çdo kufizim i lirisë duhet të jetë i ligjshëm, i domosdoshëm dhe jo arbitrar.

Shkelje konkrete:

Arresti bazohet në thënie të kallëzuesëve dhe dëshmitarëve, që në fakt nuk janë të verifikuara apo shoqëruara me prova të dokumentuara.

Nuk tregohet lidhja direkte e personit nën hetim dhe veprat penale për të cilën pretendohet dhe po hetohet.

Proporcionaliteti dhe “diskriminimi për arsye politike” – Neni 18 i Kushtetutës Shqipërisë.

Parimi i proporcionalitetit është një **standard juridik** i rëndësishëm që kërkon që: Masat që kufizojnë të drejtat themelore të jenë të nevojshme dhe të përshtatshme për arritjen e një qëllimi legjitim.

Të mos tejkalojnë atë që është e domosdoshme për arritjen e atij qëllimi (pra, të jenë proporcionale në kuptimin e ngushtë).

Në rastet kur shteti ndërhyr në të drejtat e individit – për shembull, nëse një ligj krijon një dallim ndërmjet individëve apo grupeve – Gjykata Kushtetuese do të analizojë:

Nëse qëllimi i ligjit është legjitim,

Nëse mjeti i përdorur është i përshtatshëm dhe i nevojshëm,

Nëse përfitimi publik është në ekuilibër me kufizimin që i bëhet të drejtës individuale.

Diskriminimi për arsye politike ndalohej qartë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga ligjet e tjera për të drejtat e njeriut. Ky është një nga format më të rëndësishme të diskriminimit të ndaluara, sepse ndikon drejtpërdrejt në **lirinë e mendimit politik, lirinë e shprehjes, dhe të drejtën për pjesëmarrje në jetën publike**

A ka prova që justifikojnë kufizimin e menjëhershëm të lirisë?

A ka masa më të buta që mund të përdoren (arrest shtëpie, ndalim daljeje jashtë shtetit, detyrim paraqitjeje)?

A është ndaluar liria vetëm për të dhënë **mesazh politik apo publik**?

Gjykata nuk mund të miratojë automatikisht kërkesën e prokurorisë për masë shtrënguese të heqjes lirisë pa:

Një analizë të **rrezikut konkret**;

Vlerësimin e **kohës së kryerjes së veprës**;

Ndikimin e kalimit të kohës në **rrezikun e përsëritjes ose pengimit të hetimit**.

Gjykatat kanë miratuar “Arrest në burg” për një figurë të lartë publike:

Pa **prova konkrete**;

Pa **arsyetim të plotë mbi proporcionalitetin**;

Pa shqyrtim të mundësisë së **masave alternative**;

Dhe për një **vepër të kryer shumë kohë më parë**, kjo do të përbente një **shkelje të së drejtës për liri dhe siguri, proces të rregullt ligjor**, si dhe do të jepte shenja të **instrumentalizimit të drejtësisë**.

Qëndrimi i GJEDNJ – PARIME BAZË

“Dyshimi i arsyeshëm” duhet të bazohet në fakte konkrete.

Dyshimi duhet të jetë **i bazuar në të dhëna objektive**, jo thjesht në spekulime apo indicie të përgjithshme. Nuk mjafton që një person të jetë i njohur publikisht ose të ketë qenë në poste të larta për të justifikuar masë arresti.

Privimi nga liria është një masë ekstreme që duhet justifikuar më së miri.

Nëse një hetim është në fazë fillestare dhe nuk ka akuzë të saktë apo prova materiale, masa e arrestit është e papërshtatshme dhe shkelëse. Kalimi i kohës dobëson justifikimin për masën shtrënguese “Arrest në burg”.

Rastet Kryesore nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

Fox, Campbell and Hartley v. UK (1990)

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, vendosi se, nuk është e mjaftueshme të thuhet “dyshohet për terrorizëm” pa dhënë prova konkrete për dyshimin.

Dyshimi i arsyeshëm nënkupton ekzistencën e fakteve ose informacionit që do të bindnin një vëzhgues objektiv se personi i ndaluar mund të ketë kryer një vepër penale.

Murray v. UK (1996)

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, theksoi se mungesa e informimit për akuzën në momentin e arrestimit përbën shkelje të nenit 5(2). Në rastin konkret personi nën hetim, ish-Presidenti i Republikës, Z. Ilir Metaj në momentin e arrestimit deri në momentin e kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese nuk është njoftuar për akuzën konkrete, çka e bën procedurën e ndjekur nga prokuroria dhe vendimet e gjykatave si vendime që bien ndesh me parimet bazë të lirive dhe të drejtave të njeriut të sanksionuara nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Kadem v. Malta (2013)

Një person u mbajt në burg pa akuzë konkrete për disa javë. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e konsideroi këtë shkelje të rëndë të së drejtës për liri, pavarësisht se ekzistonte “dyshim i përgjithshëm”.

Në rastin objekt kërkesë shtetasi Z. Ilir Metaj po mbahet në ambientet e paraburgimit pa akuzë prej rreth 8 muajsh. Padyshim ky veprim po cënon rëndë të drejtën për liri, pavarësisht se ndaj tij ka një dyshim të përgjithshëm, të paformalizuar në akuzë zyrtare.

Në rastin Assenov v. Bullgaria (1998)

Arrestimi pa arsye konkrete dhe pa shqyrtim real nga gjykata për rrethanat individuale u shpall i paligjshëm.

Në kuptim të shembujve të sipërcituar nga disa vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, del qartë se, vendimet e të tre gjykatave janë marrë në zbatim të

gabuar të ligjit procedural penal, Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Qëndrimi ndaj personave publikë (Diskriminimi për arsye politike – Neni 18 i Kushtetutës) **Diskriminimi për arsye politike** ndalohet qartë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga ligjet e tjera për të drejtat e njeriut. Ky është një nga format më të rëndësishme të diskriminimit të ndaluara, sepse ndikon drejtpërdrejt në **lirinë e mendimit politik, lirinë e shprehjes, dhe të drejtën për pjesëmarrje në jetën publike.**

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk pranon që:

Vetëm për shkak të **profilit publik** të një personi, apo për qëllime “ekzemplari” ose presioni publik, të justifikohet arresti apo ndalimi pa **bazë ligjore të fortë dhe akuzë të saktë.**

Në fakt, përdorimi i arrestimit ndaj ish-zyrtarëve të lartë pa një akuzë të formalizuar dhe me justifikimin “rrezik shkatërrimi provash” është shpallur në disa raste si abuziv dhe politikisht i motivuar.

Konkluzion

Vendosja e masës së arrestit pa akuzë konkrete, vetëm me dyshime të përgjithshme, ndaj ish-Presidentit të Republikës, Z. Ilir Metaj, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

Nenin 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Jurisprudencën konsistente të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Parimet e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave themelore.

Prandaj, nëse në Shqipëri një figurë publike arrestohet vetëm mbi bazë dyshimi, pa një akuzë formale dhe pa prova ose akuzë konkrete dhe që justifikohet vetëm me togfjalëshin përbën rrezik sipas pikës 3 të nenit 228 Kodit Procedurës Penale është në shkelje të parimeve kushtetues edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

D. PËR TË DREJTËN PËR PROCES TË RREGULLT

Për cenimin e së drejtës të aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

E drejta e aksesit dhe standardi i arsytimit të vendimeve gjyqësore për shkak të mënyrës se si gjykatat kanë trajtuar çështjen në rastin e kërkuarit. Ato nuk i kanë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të rëndësishme për ligjshmërinë e procesit të ndalimit të kërkuarit dhe caktimit të masës dhe interpretimit të dispozitave procedurale që parashikojnë kriteret dhe kushtet për caktimin e masës.

Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme dhe kërkuari nuk ka marrë përgjigje për to, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, çka përbën cenim të së drejtës themelore për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal.

Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (**Shih vendimet nr. 58, datë 13.11.2023; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese**). Për sa i përket kufizimit të lirisë personale, Gjykata ka pohuar se organet e pushtetit publik kanë detyrimin të respektojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe ndaj personave të cilëve sipas ligjit u është kufizuar liria, pasi, ashtu si të drejtat e tjera, edhe kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme (**Shih vendimin nr. 5, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese**).

Në rastin e kërkuarit gjykatat, por në veçanti Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuari në rekurs dhe atyre që kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore procedurale penale. Po ashtu, vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore, nuk janë logjike dhe nuk i kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuarit. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh asnjë nga provat dhe pretendimet e ngritura nga kërkuari dhe nuk kanë analizuar provat e ndodhura në dosjen gjyqësore. Vendimet gjyqësore që kanë vlerësuar masën e sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuarit janë arbitrare dhe të njëanshme në arsyetimin e tyre dhe nuk kanë bërë një vlerësim të drejtë dhe proporcional për akuzat që rëndojnë mbi kërkuarin

dhe kohën e pretenduar të veprave të supozuara, rrezikshmërinë shoqërore të tij dhe masën e sigurimit të cilën i kanë vendosur.

Gjykatat kanë arsyetuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe të njërit prej këtyre shkaqeve: ekzistencës së shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës ose kur i hetuari është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; ose kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të tij ka rrezik që ai të kryejë krime të tjera. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë arsyetuar për vendosjen e masës së sigurimit, duke mbajtur në konsideratë kontekstin e përgjithshëm të fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është duke u kryer hetimi, si dhe se nëse ajo është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur.

Gjykatat në vlerësimin e tyre për masën e sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm për arsyet të cilat kanë justifikuar vendosjen e saj, duke mos arsyetuar për “masën e duhur” të sigurimit personal dhe nëse ajo ishte e “mjaftueshme” për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar. Po kështu, ato (gjykatat) nuk kanë analizuar dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova, se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, rrezikun që paraqet ai për t’iu shmangur hetimit, si edhe prishjes ose të vërtetësisë së provave, nëse ndaj tij nuk do të vendosej ajo masë e sigurimit personal.

Në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas vendosjes së masës konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë analizuar dhe vlerësuar edhe rëndësinë e faktit, në drejtim të rrezikshmërisë së veprës penale. Në këtë aspekt, gjykatat nuk kanë evidentuar se vepra penale që dyshohet të jetë kryer në rastin konkret paraqet një rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Po ashtu, gjykatat nuk kanë analizuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga kërkuesi, sikundër edhe për ekzistencën e kushteve të veçanta për caktimin e masave të sigurimit personal. Gjithashtu, ato (gjykatat) nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm edhe në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit personal, duke mos parashtruar arsyet se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret diktonin caktimin ndaj kërkuesit të asaj mase siguri personal dhe jo ndonjë masë tjetër siguri personal. Vendimet gjyqësore nuk përmbushin

elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

Arrestimi për arsye politike, në shkelje të nenit 17/1 dhe 2 të Kushtetutës dhe të nenit 18 KEDNJ

Kufizimet e të drejtave të tij sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së, viktimë e të cilave ai ishte në këto procedura, zbatohen për qëllime që nuk lejohen nga neni 17/1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nga neni 18 i Konventës. Parimet e zbatueshme në lidhje me Nenin 18 janë elaboruar nga Gjykata në çështjen **Merabishvili kundër Gjeorgjisë** [GC], nr. 72508/13, 287-317, 28 nëntor 2017, dhe janë elaboruar më tej në **Navalny kundër Rusisë** [GC], nr. 29580/12 dhe 4 të tjerë, 164-65, 15 nëntor 2018, dhe **Selahattin Demirtaş kundër Turqisë** (Nr. 2), [GC], nr. 14305/17, 421-438, 22/12/2020.

Duke pasur parasysh këto parime të përpunuara nga Gjykata, faktet e mëposhtme mbështesin zbatueshmërinë dhe shkeljen e Nenit 18, në lidhje me Nenin 5 dhe Nenin 3 të Protokollit 1.

Në datën 7 maj 2022, nga tribuna e Asamblesë së Partisë Socialiste, Kryeministri Edi Rama deklaroi publikisht se “e gjithë Shqipëria mezi pret ta shohë përpara SPAK-ut, Ilir Metën”. (Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=q-xv6sZS4s4>)

Në 17 nëntor 2022, Halit Valteri, ish-deputet, dy herë kandidat për deputet i PS dhe anëtar i PS në Këshillin Bashkiak të Tiranës, deklaronte publikisht se “i pari që duhet të arrestohet është Ilir Metaj”. Gjithashtu, në datën 24 prill 2024, deklaronte se “Ilir Metaj do arrestohet dhe nuk i kap zgjedhjet e vitit 2025”.

(Shih: https://www.youtube.com/watch?v=vnW351Z3h_M)

(Shih: <https://www.youtube.com/shorts/CnfAOvhGt0s>)

Arrestimi i Z. Metaj nuk është as rastësi, dhe as unik. Ai është pjesë dhe vijimësi e një strategjie të përhershme të Kryeministrit Rama për të goditur me anë procedurash gjyqësore kundërshtarët politikë. Njësoj si Navalny në Rusi. Arrestimi i Z. Metaj është vazhde e një serie të provuar aktesh të tilla, disa nga të cilat, për kujtesën e Gjykatës Kushtetuese, po i rendisim më poshtë:

- Ish-Presidenti i Republikës dhe ish-Kryeministri, Z. Sali Berisha, u mbajt për gati një vit në arrest shtëpie në vit elektoral. Ankimi i tij në Strasburg me pretendime të ngjashme me këto të Z. Metaj është në shqyrtim si “leading case”.

- Familjarë të ish-Kryetarit të Partisë opozitare, Z. Basha, u goditën personalisht duke iu shkatërruar pronën. Ky veprim i Qeverisë është konsideruar shkelje e disa neneve të KEDNJ nga Gjykata e Strasburgut në 11.1.2018.
- Ish-zyrtari i lartë i FBI, Charles McGonigal, i cili është duke vuajtur dënimin e tij në SHBA, sipas akt-akuzës së drejtësisë amerikane, u provua se u korruptua nga Kryeministri Rama (përmendet 14 herë në akt-akuzë), për të goditur opozitën dhe politikanë të caktuar opozitarë në Shqipëri, përfshi Z. Ilir Metaj.
- Një tjetër deputet i opozitës, Z. Ervin Salianji, i cili pati sukses në zgjedhjet lokale të vitit 2023, bëri 9 muaj burgim pse denoncoi vëllain trafikant droge të ish-ministrit të Brendshëm, i cili vetëm pas këtij denoncimi u dorëzua në Itali të kryente dënimin.
- Televizioni “Agon Channel” u mbyll për kritika ndaj Qeverisë dhe Qeveria refuzon publikisht të paguajë një vendim arbitrazhi nga ICSID në favor të pronarit të atij televizioni kundër Qeverisë.
- Pronari i Hysenbelliu Group dhe gazetat e tij u sulmuan nga Qeveria në vitet 2022-2023 sepse filloi të kritikonte Qeverinë.
- Një kandidat për Kryetar Bashkie në zgjedhjet lokale në jug të Shqipërisë, Z. Fredi Beleri, aktualisht eurodeputet në Parlamentin Europian, u ndalua për të ndaluar zgjedhjen e tij si Kryetar Bashkie dhe u lirua vetëm pasi u zhvilluan zgjedhjet dhe u zgjodh kandidati i Qeverisë.

Koincidenca kohore politike e këtyre goditjeve ndaj personave specifike të opozitës, tregon për një përndjekje me regji për arsye politike dhe përodrimin e gjyqësorit si armë politike nga Kryeministri.

Është cënuar pluralizmi politik, një parim themelor i rendit kushtetues (**Shih** preambulën dhe Nenin 1 të Kushtetutës).

Nëse një person që është zgjedhur për një funksion politik (kryetar partie opozitare) nuk lejohet ta ushtrojë këtë funksion, për arsye që nuk janë të bazuara në ligj ose janë të stërzgjatura në kohë pa vendim përfundimtar, kjo padyshim është një ndalim arbitrar dhe ndërhyrje në proceset demokratike.

Kërkuesi personi nën hetim Z. Ilir Metaj, aktualisht është Presidenti i Partisë Lirisë, partia e dytë më e madhe opozitare dhe partia e tretë politike në Shqipëri në 20 vitet e

fundit. Me vendimet e gjykatave që kanë vendosur atë nën masën shtrënguese “Arrest në burg”, nuk është privuar vetëm liria dhe e drejta e jetës, por edhe privimi i ushtrimit të funksionit publik si President i partisë së dytë opozitare dhe në prag të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025.

Padyshim, që masa shtrënguese “Arrest në burg” kërkuar nga ana e organit të akuzës dhe e pranuar nga gjykatat është një akt politik, pasi veprimet e organit të akuzës kanë ndodhur nën diktatin e Kryeministrit, Edi Rama, i cili nga foltorja e Asamblesë së Partisë Socialiste, më 7 maj 2022 urdhëroi publikisht Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar se duhet të vepronte për të burgosur Presidentin e Republikës, Z. Ilir Metaj, pasi këtë sipas tij e kërkonte opinioni publik.

(Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=q-xv6sZS4s4>)

Arrestimi i Z. Metaj më 21 tetor 2024, ndodhi në një kryqëzim të ngarkuar në Tiranë pranë “Casa Italia”, ku automjeti me të cilin lëvizte ish-Presidenti i Republikës, u bllokua qëllimisht nga disa automjete private pa shenja identifikuese dhe pa asnjë mbishkrim policor, nga të cilat dolën dhjetëra persona të armatosur rëndë dhe me maska, të veshur me uniforma të zeza pa logo, pa distinktiva apo shenja identifikuese, të cilët rrethuan zonën duke krijuar një atmosferë terrori për qytetarët që ishin të pranishëm.

Ish-Presidenti i Republikës, Z. Ilir Metaj u nxorr forcërisht nga automjeti me të cilin udhëtonte, u rrëmbye me dhunë, u tërhoq zvarrë mes publikut nga personat me maska, me një trajtim kriminal, denigrues dhe degradues, pa ju komunikuar asnjë vendim gjyqësor dhe pa ju lexuar të drejtat, që i takonin, sipas Kushtetutës dhe po në mënyrë të dhunshme u detyrua forcërisht të hipte në një nga automjetet private që i bllokuan rrugën. (Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=GyRp1yR5LFs>)

Padyshim, që masa shtrënguese e “Arrest në burg” ndaj Presidentit të Partisë Lirisë dhe ish-Presidentit të Republikës, Z. Ilir Metaj është politike, sepse po kjo shumicë qeverisëse Partia Socialiste dhe Kryeministri, Edi Rama e ka shprehur publikisht se: “Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin Organizuar SPAK e kemi krijuar ne, e financojmë ne, edhe reformën në drejtësi e kemi bërë ne”.

(Shih: <https://www.youtube.com/shorts/iPQ7qHGcHBk>
<https://www.youtube.com/shorts/cPZhnrZm3uo>
<https://www.youtube.com/shorts/DnWbvNXRsSg>
<https://www.youtube.com/watch?v=ldlkxdep9BY&t=47s>)

Mjaftojnë këto fjalë dhe nuk ka më asnjë dyshim që arrestimi i ish-Presidentit të Republikës, Z. Ilir Metaj është i nxitur dhe motivuar politikisht në prag të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025.

Z. Metaj asnjëherë nuk ka refuzuar hetimin apo ftesat e SPAK dhe ne nuk jemi kundër hetimit për çdo dyshim që mund të ketë Prokuroria e Posaçme, por jemi kundër dhe kundërshtojmë veprimet dhe vendimet antikushetuese të gjykatave shqiptare që nuk analizojnë drejt, ngjarjet, personat, kohën kur mund të jetë kryer vepra penale, rrezikshmërinë e personit dhe rëndësinë e tij.

Ndërkohë që drejtuesi i Prokurorisë Posaçme (SPAK), Altin Dumani para Këshillit të Lartë të Prokurorisë u shpreh se “.....**Gjykatat afërmendsh vendosin çfarë kërkojmë ne....**” dhe kjo vërtetohet edhe me faktin që sot në burgjet shqiptare numri i të paraburgosurëve ka kaluar numrin e të burgosurëve, ose më konkretisht, 70% e popullsisë që gjendet në burgjet shqiptare janë të paraburgosur. (Statistika të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve).

(Shih: <https://www.syri.net/politike/677566/altin-dumani-pranon-ekzistencen-e-republikes-se-prokuroreve-afermendsh-qe-gjykata-vendos-sic-duam-ne/>)

Po kështu, Z. Metaj ka kundërshtuar të drejtën e SPAK për të përgjuar gjykatat si çënim të pavarësisë së tyre.

Po kështu, Z. Metaj ka kundërshtuar kërkesën publike të Z. Dumani për një zgjatje tjetër 9-vjeçare të anëtarëve të SPAK në kundërshtim me frymën e dakordësuar të Reformës në Drejtësi, që u bë me konsensus të plotë në vitin 2016 sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

Në Neni 17 të Kushtetutës thuhet se:

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Çështja Mammadov v. Azerbajjan – arrest politik për motive të fshehura si ndjekje penale. Ky rast ka ngjashmëri me çështjen e Z. Ilir Metaj, i cili është sulmuar politikisht në mënyrë publike, madje duke shpikur edhe gjëra të paqëna nga jeta e tij private studentore në vitet 1990.

Në çështjen **Gëllçi kundër Shqipërisë**, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, vendosi më 25 shkurt 2025 se, Shqipëria kishte shkelur të drejtën e Thoma Gëllçit për liri personale, sipas nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gëllçi, ish-drejtor i Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), u arrestua në tetor 2021 nën akuzën e shpërdorimit të detyrës lidhur me një tender publik për pajisje teknike. Ai u mbajt në paraburgim për më shumë se shtatë muaj, pa u ngritur akuzë formale. Në qershor 2022, ai u dënua me një vit e katër muaj burg, por u lirua më 30 gusht 2022 pasi kishte vuajtur pjesën më të madhe të dënimit në paraburgim.

Gjykata Europiane të Drejtave të Njeriut konstatoi se, autoritetet shqiptare nuk kishin ofruar arsye të mjaftueshme dhe specifike për të justifikuar paraburgimin e gjatë të Gëllçit. Gjykata theksoi se, megjithëse ekzistonte dyshim i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale, nuk ishte shpjeguar pse masat më të lehta sigurie nuk ishin marrë parasysh. Gjithashtu, nuk ishte vlerësuar rreziku i arratisjes dhe nuk ishte arsyetuar pse paraburgimi duhej të vazhdonte. Gjykata kritikoi edhe mungesën e një vlerësimi të rregullt të nevojës për paraburgim gjatë zhvillimit të çështjes.

Si rezultat, Gjykata urdhëroi që shteti shqiptar t'i paguante Gëllçit 500 Euro si dëmshpërblim jopasuror dhe 5,000 Euro për shpenzimet ligjore. Ky vendim është një paralajmërim për praktikën e përdorimit të tepruar të paraburgimit në Shqipëri dhe thekson nevojën për respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Edhe kërkuesi personi nën hetim Presidenti Partisë Lirisë, dhe ish-Presidenti i Republikës, Z. Ilir Metaj, është në të njëjtat kushte, ka rreth 9 (tetë) muaj në paraburgim (edhe koha e gjatë e kaluar në paraburgim përbën shkelje të Nenit 17 të Kushtetutës. Joproporcionaliteti edhe për shkak të kohës së gjatë në paraburgim).

Paraburgimi është masa më e rëndë e sigurimit personal, dhe si e tillë duhet të përdoret me kujdes, për një kohë të arsyeshme, vetëm kur nuk ka masa më të lehta që sigurojnë mbarëvajtjen e procesit penal (si ndalimi i largimit nga vendbanimi, garancia pasurore etj.

Paraburgimi zgjatet përtej një kohe të arsyeshme, pa justifikim konkret dhe të bazuar.

Autoritetet nuk tregojnë kujdes për të përparuar hetimin apo gjykimin në mënyrë efikase.

Masa e paraburgimit përdoret për të "ndëshkuar" indirekt një person pa vendim përfundimtar fajësie.

Shkeljet kushtetuese të gjykatave të të tre shkallëve të gjykimit janë evidente sepse masa e “Arrest në burg” ndaj një personi publik, President i një partie politike opozitare por edhe ish-President i Republikës, është jo propocionale.

Arsye këto që mbajtja në paraburgim pa përmbushje të kushteve ligjore (neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale) por dhe shkeljeve të mundshme kushtetuese dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

- **Neni 17 i Kushtetutës:** Kufizimi i të drejtave dhe lirive.
- **Neni 27 i Kushtetutës:** E drejta për liri dhe siguri personale.
- **Neni 28 i Kushtetutës:** Presumimi i pafajësisë dhe shkelja e garancive procedurale për personat e arrestuar, në mënyrë të veçantë trajtimi dinjitoz.

1. Sipas kësaj dispozite dhe nenit 3 të **KEDNJ**, askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor apo degradues.

Kjo do të thotë se personi i arrestuar nuk duhet të keqtrajtohet fizikisht apo psikologjikisht, duhet të mbahet në kushte të pranueshme dhe të trajtohet me respekt për dinjitetin e tij.

2. E drejta për t’u informuar për arsyet e arrestimit.

Sipas nenit 28/2 të Kushtetutës dhe nenit 5/2 të KEDNJ, personi i arrestuar duhet të njoftohet menjëherë dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit dhe për çdo akuzë kundër tij.

3. E drejta për një mjek dhe për kujdes shëndetësor

Të arrestuarit kanë të drejtë të vizitohen nga një mjek i pavarur, veçanërisht nëse ankohen për keqtrajtim ose nëse ndodhen në gjendje të keqe shëndetësore.

Kjo ndihmon gjithashtu në mbrojtjen e tyre nga tortura apo keqtrajtimi, pasi ekzaminimi mjekësor është një mjet verifikimi objektiv.

4. E drejta për kontakt me familjen

Të arrestuarit kanë të drejtë të njoftojnë një anëtar të familjes ose një person tjetër të besuar për arrestimin e tyre.

Kjo siguron një rrjet mbështetjeje dhe kontroll mbi trajtimin nga autoritetet.

5. E drejta për një avokat

Personi i arrestuar ka të drejtë të konsultohet me një mbrojtës ligjor (avokat) që nga momenti i arrestimit (neni 28/5 i Kushtetutës).

Pra këto garanci kushtetuese nuk janë zbatuar në rastin e arrestimit të ish-Presidentit Z. Ilir Metaj. Në momentin e ndalimit nga Forca e Posaçme Operacionale, nuk i kanë treguar asnjë dokument identifikimi që të kuptohej se ishin forcat e policies, gjithashtu as urdhërin e ekzekutimit të vendimit gjykatës për arrestim.

Në kuptim të kësaj procedure Z. Metaj nuk ju garantuan të drejtat procedurale për të patur një avokat në momentin e ndalimit. Avokati tij ka shkuar në ambientet e

Drejtorisë së Policisë të Tiranës në mënyrë vullnetare i panjoftuar nga askush sepse ka parë në mediat pamjet filmike të rrëmbimit. Edhe familjarët e tij nuk janë njoftuar nga policia, dhe në këtë mënyrë janë shkelur dhe dhunuar garancitë kushtetuese dhe ato të KEDNJ.

Neni 18 i Kushtetutës: Barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit politik.

Neni 3 i KEDNJ për keqtrajtim në momentin e arestit

Neni 5 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut: Ndalimi arbitrar.

Neni 228/3 i KPP: Paraburgimi lejohet vetëm nëse ka **rrezik për prishje provash, rrezik arratisjeje ose rrezik për përsëritje të veprës penale.**

Neni 5 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimet e gjykatave nuk përmbajnë shpjegim të qartë, të plotë dhe logjik për bazat ligjore dhe faktike që justifikojnë atë vendim të masës së sigurimit personal të “Arrest në burg”.

Kjo qasje është një shkelje e rëndë procedurale, sepse një gjykatë është e detyruar të japë arsyetim të argumentuar për çdo vendim që merr, sidomos kur kufizon të drejtat themelore të individit si liria personale në rastet e paraburgimit.

Gjykatat kanë qenë të njëanshme, jo në mënyrë të drejtë dhe të balancuar, por kanë favorizuar vetëm një palë në mënyrë të padrejtë gjatë shqyrtimit të çështjes dhe në vendimmarrje.

Favorizim i dukshëm ndaj prokurorisë apo mbrojtjes, duke refuzuar pa arsye kërkesat e një palë dhe miratuar të tjerat pa analizë.

Të gjykosh me paragjykim – të japësh opinion për fajësinë e një personi para përfundimit të gjykimit.

Të mos dëgjosh palët në mënyrë të barabartë – të ndërpresësh sistematikisht avokatin e mbrojtjes por jo prokurorin.

Të mbështetesh vetëm në një grup provash që favorizojnë një palë, duke injoruar provat e tjetrit.

Të përdorësh gjuhë jo neutrale në vendim – për shembull, t’i referohesh të pandehurit si "fajtor" para se të jepet vendimi përfundimtar apo recidivist kur ai kurrë nuk ka qenë i dënuar më parë nga asnjë gjykatë.

(Shih: <https://www.syri.net/politike/677566/altin-dumani-pranon-ekzistencen-e-republikes-se-prokuroreve-afermendsh-qe-gjykata-vendos-sic-duam-ne/>)

Pra gjykatat kanë vepruar pikërisht në këtë mënyrë, kanë favorizuar qartësisht prokurorin, duke i marë si të mirëqëna plotësisht provat e paraqitura, ndonëse jemi në një moment procedural të prezumimit të pafajësisë, por edhe të masës së sigurimit personal, ku provat duhet të merren me shumë rezerva nga gjykata.

Gjatë gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë, avokati është ndërprerë disa herë nga gjykata gjoja me arsyetimin se duhet të ishte brenda kontekstit të çështjes, ndonëse avokati ishte në sqarim të rrethanave, dinamikës por edhe mënyrës së arrestimit të ish-Presidentit të Republikës.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) thekson në shumë vendime se: “Për një proces të rregullt ligjor, është thelbësore që gjykata jo vetëm të jetë e paanshme në realitet, por edhe të duket si e tillë.”

(Rasti Piersack kundër Belgjikës, 1982)

Pra, edhe perceptimi publik i njëanshmërisë mund të përbëjë problem.

Gjykatat në vendimet e tyre nuk kanë marë parasysh prezumimin e pafajësisë, duke anashkaluar faktin që: Prezumimi i pafajësisë është një parim themelor i së drejtës penale dhe procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit çdo person i akuzuar për një vepër penale konsiderohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia e tij me një vendim përfundimtar gjyqësor.

Neni 30 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

“Kushdo që akuzohet për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, deri sa të shpallet fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë.”

Në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ):

Neni 6, paragrafi 2: “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia e tij sipas ligjit.”

Nëse personi nuk ushtron funksion publik, nuk ka mundësi të ndikojë mbi prova ose dëshmitarë, dhe nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore (vepra nuk është e dhunshme ose personi ka profil të lartë publik), “**masa e sigurisë me burg**” konsiderohet jo proporcionale dhe e pajustificuar, duke cenuar liritë themelore të njeriut dhe duke mos marë parasysh prezumimin e pafajësisë.

Për sa më sipër, i kërkojmë Gjykatës Kushtetuese:

Pranimin e kërkesës;

Shfuqizimin si antikushtetues të:

Vendimit penal gjyqësor Nr.57, datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

Vendimit penal gjyqësor Nr. 59 (97-2024-333) datë 19.11.2024, të Gjykatës së
Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

Vendimit penal gjyqësor Nr.125, datë 20.10.2024 dhe Nr.130 datë 23.10.2024 të
Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

**Përfaqësuesi ligjor
Kërkuesi**

**Studio Ligjore “CAKRANI”
Av. Kujtim CAKRANI
Av. Dylejman KARAJ**

Ilir METAJ